



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 11 regjistër (JR)
Datë 21.03.2024

Nr. 53 i vendimit
Datë 31.10.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 31.10.2024, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen nr. 11/2024 (JR), datë 21.03.2024, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 725, datë 15.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F, pikat 2 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 59, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “a” dhe shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 49 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtime, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 725, datë 15.12.2023, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

1. Subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet ndihmëse përkatëse deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata vetting”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

3.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ka konstatuar se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

3.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve në deklaratën për kontrollin e figurës dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi, dhe me shkresën nr. {***}, datë 05.10.2023, raportin e deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 05.10.2023, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit.

3.3. KLP-ja ka dërguar në Komision raportin vlerësues për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Bazuar në kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), referuar neneve 71-76, KLP-ja ka analizuar lidhur me: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi, bazuar në tri kriteret e vlerësimit, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 725, datë 15.12.2023.

II. Vendimi i Komisionit

5. Komisioni, me vendimin nr. 725, datë 15.12.2023, lidhur me të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, ka konkluduar se:
 - *Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke e vënë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*
 - *Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit (i) ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “ç” të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk ka plotësuar saktësisht, plotësisht dhe me vërtetësi formularin për kontrollin e figurës dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar kontaktin e papërshtatshëm që është konstatuar nga prova të besueshme, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të pikës 6 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 dhe në kushtet e nenit Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*
 - *Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, problematikat e konstatuara në kriterin e figurës, të ndërthurura me mangësitë profesionale, janë të tilla që kanë cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë e, për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*
6. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni, në bazë të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikat 2, 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hektor Mushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

III. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me vendimin e Komisionit

7. Subjekti i rivlerësimit, në datën 08.03.2024, i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) me ankim kundër vendimit nr. 725, datë 15.12.2023, të Komisionit, duke kërkuar: *Çeljen e hetimit gjyqësor dhe shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Ndryshimin e vendimit nr. 725, datë 15.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Hektor Mushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.*
8. Në ankimin drejtuar Kolegjit kundër vendimit të Komisionit nr. 725, datë 15.12.2023, subjekti i rivlerësimit parashtrohet, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

Shkaqe ankimi lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

9. *Për pasurinë apartament me sip. 92,3 m², me vlerë 2.000.000 lekë, në Pogradec*, subjekti pretendon se çmimi i kontratës së shitblerjes midis palëve është real, i logjikshëm dhe i dokumentuar. Për sa i përket faktit që në kontratën e shitblerjes së apartamentit, nuk është evidentuar se apartamenti është blerë në gjendje karabina, subjekti sqaron se në ato vite, kontratat nga ana e sipërmarrësve, të bëra para noterit, ishin kontrata tip, pa parashikime e specifikime, por duke identifikuar vetëm apartamentin dhe çmimin. Për sa u përket shpenzimeve për punime dhe mobilimin e apartamentit, subjekti parashtrohet në ankim se ai është bërë pronar i apartamentit në datën 02.11.2004, dhe në periudhën 2005-2007 ka kryer vetë punime në vlerë 750.000 lekë, të ndara si shpenzime për tri vite radhë. Për pasojë, është i gabuar qëndrimi i Komisionit i cili shumë prej 750.000 lekësh e ka përfshirë në analizën e vitit 2004, kur në realitet ky shpenzim është kryer në periudhën 2005-2007. Subjekti pretendon se ka qenë në pamundësi për të siguruar dokumentacionin për shpenzimet e kryera në periudhën 2005-2007, për punimet dhe mobilimin e apartamentit, pasi shoqëritë që kanë kryer punimet janë mbyllur dhe shumë gjëra janë blerë të përdorura.

9.1 Lidhur me burimin e krijimit të apartamentit, për sa i përket dhurimit nga vëllai A. P. (M.) të vlerës prej 1.500.000 lekësh për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se vëllai nuk ka pasur burime të ligjshme për t’i dhuruar këtë shumë. Sipas subjektit, Komisioni ka bërë përllogaritje të gabuara të shpenzimeve të jetesës së vëllait si emigrant dhe student në Gjermani, pasi është bazuar në të dhënat e Eurostat, ndërkohë që kjo llogaritje duhej të ishte bërë sipas ligjit federal gjerman mbi ndihmën për financimin e studimeve (Ligjit Bafög), sipas të cilit, për periudhën 01.08.1995 - 21.01.2004, shpenzimet e llogaritura janë 37.628 euro, dhe jo 78.248 euro, sipas llogaritjes nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu pretendon se analiza financiare e Komisionit për blerjen e apartamentit në vitin 2004, nuk është e saktë, pasi shpenzimet e arredimit dhe të punimeve për apartamentin për këtë vit, kanë qenë në vlerën 250.000 lekë (po në këtë vlerë edhe për vitet 2005 dhe 2006), dhe jo në vlerën 750.000 lekë, siç e ka llogaritur Komisioni.

10. *Për apartamentin me sip. 112 m² në Elbasan (në përdorim të subjektit, në pronësi të nënës së tij)*, subjekti i rivlerësimit parashtrohet në ankim se personat e lidhur, nëna e babai i tij, kanë pasur burime

të ligjshme financiare për të kryer pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit në shumën prej 3.000.000 lekësh. Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë në analizë financiare të ardhurat nga punësimi i babait në shoqërinë “{***}” ShPK, për periudhën 01.02.1995 - 31.12.1997.

10.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon dhe se dokumentohet dhe është e ligjshme dhënia e huasë në shumën 10.000 euro nga kushërira T. L. (D.) për vëllain D. M., hua e cila ka ndihmuar për pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit në Elbasan nga babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, subjekti kundërshton llogaritjen e kryer nga Komisioni për shpenzimet e vëllait D. M., si student në Gjermani, në analizën financiare për periudhën 26.08.2003 - 31.12.2006, duke pretenduar se këto shpenzime kanë qenë më të ulëta dhe se duhet të llogariteshin sipas standardit të jetesës së një studenti.

10.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për fshehje të pronësisë mbi këtë apartament në emër të prindërve, pasi ai e ka deklaruar këtë pasuri si vendbanim në mënyrë të përsëritur në ILDKPKI, në deklarimet periodike vjetore, si dhe në deklaratën *vetting*. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar kontributin financiar për blerjen e këtij apartamenti nëpërmjet kredisë bankare, dhe kjo pasuri nuk mund të kualifikohet si një pasuri e fshehur, për sa kohë që ekzistenca, pronësia e nënës dhe përdorimi prej tij i apartamentit është deklaruar saktë në deklarimet periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*.

10.3. Subjekti pretendon dhe se për këtë apartament, Komisioni, në mënyrë të gabuar dhe të kundërligjshme, i ka kaluar barrën e provës për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të babait, ndërkohë që babai i tij, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka qenë as në cilësinë e dhuruesit dhe as në atë të huadhënësit.

Shkaqe ankimi lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

11. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se nuk e ka vetëdeklaruar kontaktin me shtetasin Th. B. pasi, në dijeninë e tij, ky shtetas nuk ka qenë ndonjëherë i hetuar dhe gjykuar për ndonjë veprë penale. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni për procedimin penal në ngarkim të shtetasit Th. B., të regjistruar në muajin janar të vitit 2009, në ish-Gjykatën e Krimeve të Rënda, Tiranë, as nga ai vetë dhe as nga persona të tjerë të njohur, pasi vetë subjekti nuk ka pasur kontakte personale me këtë shtetas, por vetëm kontakte rastësore për shkak të lidhjeve familjare e shoqërore. Në nenin 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, jepet përkufizimi i “personit të përfshirë në krimin e organizuar” dhe, në rastin e Th. B., procedimi ndaj të cilit është pushuar në përfundim të hetimeve, në bazë të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, nga interpretimi i dispozitës së mësipërme, nuk rezulton që ky person të jetë i përfshirë në krimin e organizuar.

Shkaqe ankimi lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale

12. Subjekti i rivlerësimit shprehet në ankimin drejtuar Kolegjit se konkluzionet e Komisionit lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, nuk janë të bazuara dhe të provuara, por thjesht të supozuara, aq më tepër kur konkludojnë për shkelje që kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Nga Komisioni nuk janë konstatuar shkelje të rënda, siç mund të jenë kualifikimi jo i drejtë i një veprë penale, apo pushimi i akuzës në një kohë që është provuar vepra, dhe të gjitha konstatimet janë në kuadrin e dyshimeve, të prezumuara si të mirëqena.

13. Subjekti i rivlerësimit parashtrohet në ankim se u qëndron shpjegimeve të detajuara të dhëna para Komisionit lidhur me çështjet e trajtuara nga ky i fundit në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale. Konkluzionet e Komisionit nuk janë të bazuara dhe të provuara, pasi në asnjë rast Komisioni nuk ka konstatuar shkelje të rënda, për më tepër që të kualifikohen që kanë cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Në përfundim, për këtë kriter, subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë kohës së ushtrimit të detyrës, ka treguar integritet profesional dhe nuk është në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë.
14. Të njëjtat pretendime janë përsëritur nga subjekti i rivlerësimit edhe në parashtrimet para seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, të paraqitura në datën 24.10.2024.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

15. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimitimin e ankuesit

16. Ankuesi Hektor Mushi, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtuar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
17. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi, është shpallur në seancë publike më datë 15.12.2023. Vendimi i arsyetuar nr. 725, datë 15.12.2023, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***}, datë 22.02.2024, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 26.02.2024. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në datën 08.02.2024, pranë Komisionit, ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 725, datë 15.12.2023, protokolluar me nr. {***} prot., datë 08.03.2024. Bazuar në nenin 63, pika

1 e ligjit 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

c) Mbi formën e gjykimit të ankimit

18. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.
19. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për të kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

Për pasurinë apartament me sipërfaqe 92,3 m², me vlerë 2.000.000 lekë, në Pogradec

20. Komisioni për këtë pasuri ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë rrethana jo të vërteta për sa i përket gjendjes së apartamentit në momentin e blerjes, si dhe vlerës së punimeve dhe shpenzimeve për mobilim. Gjithashtu, Komisioni ka vlerësuar se të ardhurat e vëllait të subjektit, A. P. (M.), nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës e, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për t’i dhuruar subjektit të rivlerësimit shumë prej 1.500.000 lekësh. Komisioni, në përfundim, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumë prej 1.612.496 lekësh për blerjen e pasurisë apartament në Pogradec, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
21. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit duke parashtruar në ankim se çmimi i kontratës së shitblerjes midis palëve është real, i logjikshëm dhe i dokumentuar. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka kryer disa punime vetë në apartament pas blerjes së tij pasi, sipas tij, apartamenti është blerë në gjendjen karabina dhe nuk janë përfunduar punimet nga ndërtuesi. Për sa i përket faktit që në kontratën e shitblerjes së apartamentit nuk është evidentuar se apartamenti është blerë në gjendje karabina, subjekti sqaron se në ato vite, kontratat nga ana e sipërmarrësve të bëra para noterit, ishin kontrata tip, pa parashikime e specifikime, por duke identifikuar vetëm apartamentin dhe çmimin. Për sa u përket shpenzimeve për punime dhe mobilimin e apartamentit, subjekti parashtron në ankim se ai është bërë pronar i apartamentit në datën 02.11.2004 dhe në periudhën 2005-2007, ka kryer vetë punime në vlerën prej 750.000 lekësh, të ndara si shpenzime

për tri vite radhazi. Për pasojë, është i gabuar konkluzioni i Komisionit, i cili shumë prej 750.000 lekësh e ka përfshirë në analizën e vitit 2004, kur në realitet ky shpenzim është kryer në periudhën 2005-2007. Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare e Komisionit për blerjen e apartamentit në vitin 2004, nuk është e saktë, pasi shpenzimet e arredimit dhe të punimeve për apartamentin për këtë vit kanë qenë në vlerën 250.000 lekë (në këtë vlerë edhe për vitet 2005 dhe 2006), dhe jo në vlerën 750.000 lekë, si e ka llogaritur Komisioni. Subjekti pretendon se ka qenë në pamundësi për të siguruar dokumentacionin për shpenzimet e kryera në periudhën 2005-2007, për punimet dhe mobilimin e apartamentit, pasi shoqëritë që kanë kryer punimet janë mbyllur dhe shumë gjëra janë blerë të përdorura.

22. Me qëllim analizimin e këtij shkakut ankimi, trupi gjykues verifikoi deklaratet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë dhe deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, nga ku rezultoi se:

22.1. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting, ka deklaruar: *Apartament banimi me vërtetim pronësie të ZVRPP Pogradec, në emër të Hektor A. Mushi, sip. 92,3 m². Adresa: Lagjja nr. {***}, rr. "{***}", kat i {***} banim (pa ashensor), Pogradec, Zk. {***}, nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}. Kontratë shitblerjeje dt.29.10.2004, nr. {***} rep., dhe {***} kol., me vlerë 2.000.000 lekë. Zotëroj 100 %. Burimi i krijimit: një pjesë të dhuruara nga vëllai im A. (M.) P., të fituara nga puna e tij si emigrant në atë kohë në Gjermani dhe dhurata nga familjarët e mi, miq, të ftuar dhe familjarët e bashkëjetueses sime. Këto dhurata në para, më janë dhuruar me rastin e ceremonisë së martesës me bashkëjetuesen time I. B., zhvilluar më datë 21.12.2003. Gjithsej, në total 1.500.000 lekë. Pjesa tjetër prej 500.000 lekësh e pjesës së mbetur të çmimit të blerjes së banesës, është plotësuar nga kursimet e mia prej pagës si prokuror në atë kohë në Prokurorinë e Rrethit Pogradec. Tri fatura të paguara nga im vëlla në emër të tij (A. M.) për blerjen e kësaj banese, janë dorëzuar gjatë kontrollit periodik të pasurisë pranë ILDKPKI-së dhe ndodhen në dosjen time personale pranë këtij institucioni.*

22.2. Në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2004, subjekti ka deklaruar apartament banimi, sip. 92,3 m², vlera 2.000.000 lekë, me pjesë 100%, datë krijimi 02.11.2004, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

23. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues së pari konstaton se janë të pabazuara pretendimet e tij lidhur me vërtetësinë e çmimit të apartamentit sipas kontratës së shitblerjes. Nga vendimi objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni, megjithëse ka hetuar dhe ka konstatuar se çmimi në kontratën e shitblerjes është më i ulët se çmimet referuese të tregut dhe atyre të pasqyruara në kontratat e shitblerjes në të njëjtin pallat, në përfundim nuk ka konkluduar për deklaram të pavërtetë të subjektit për vlerën e blerjes, dhe ka vendosur në analizën financiare përfundimtare vlerën prej 2.000.000 lekësh, si të pasqyruar në kontratë.
24. Për sa i përket pretendimit për blerjen e apartamentit në gjendje karabina, trupi gjykues, nga verifikimi i kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2004, konstaton se një fakt i tillë nuk citohet në përmbajtjen e këtij akti. Subjekti pretendon se kontrata e shitblerjes ka qenë një kontratë tip në të cilën, sipas tij, nuk ka pasur parashikime e specifikime për

apartamentin në fjalë, duke pretenduar një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale, e cila në kuptim të ligjit përbën provë të plotë. Trupi gjykues vëren se, dhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë asnjë deklaram për blerjen e apartamentit në gjendje karabina dhe kryerjen e shpenzimeve për punime, por e ka bërë këtë deklaram vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 1. Subjekti ka paraqitur si provë në Komision, në përgjigje të rezultateve të hetimit, lejen e shfrytëzimit të miratuar me vendimin nr. {***}, datë 1.8.2003, të KRRT-së Bashkia Pogradec, për objektin “Banesë 7 kate + çati”, bashkë me procesverbalin e kolaudit, dokumente në të cilat konstatohet se nuk ka asnjë referencë për gjendjen karabina të objektit. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ, ashtu dhe me prapësimet për rezultatet e hetimit, nuk ka paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar pretendimin që apartamenti ishte marrë në dorëzim prej tij në gjendje të papërfunduar apo karabina, pretendim i cili nuk mbështetet as nga kontrata e shitblerjes, e as nga vërtetimi hipotekor nr. {***}, datë 30.12.2003, përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja, nga e cila rezulton se pasuria nr. {***}, në zonën kadastrale {***}, e llojit apartament, me sipërfaqe 93,2 m², është regjistruar në pronësi të shtetasit F. H. (shitësit), që në datën 30.12.2003, çka dëshmon mbi faktin se apartamenti ka qenë i përfunduar përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes të datës 29.10.2004.

25. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk gjejnë mbështetje as në dokumentet e administruara nga Komisioni dhe as në provat e dorëzuara prej tij, dhe ai nuk arrin të provojë se apartamenti ishte në gjendjen karabina në momentin e lidhjes së kontratës dhe se kishte punime të papërfunduara nga ndërtuesi/shitësi.
26. Lidhur me pretendimet e subjektit për kryerjen e shpenzimeve për punimet dhe mobilimin e apartamentit, trupi gjykues vëren se Komisioni ka konkluduar se nuk është i besueshëm deklarimi i subjektit gjatë hetimit administrativ se ka kryer punime të domosdoshme (bashkë me mobilimin), në vlerën prej 750.000 lekësh, në periudhën 2005 – 2007, për shkak se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë rrethana jo të vërteta për sa i përket gjendjes së apartamentit në momentin e blerjes. Për këtë arsye, Komisioni, në shpenzimet e deklaruara nga ana e subjektit, në shumën 750.000 lekë, në kushtet kur subjekti ka deklaruar se këtu përfshihen edhe shpenzimet e mobilimit, ka konsideruar vetëm këto të fundit si të tilla, duke i përfshirë në analizën e vitit 2004, referuar deklarimit të subjektit se ka filluar të banojë në këtë apartament pikërisht në vitin 2004 dhe faktit që subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues se apartamenti ishte në gjendjen karabina.
27. Për sa u përket shpenzimeve të deklaruara nga subjekti, në vlerën prej 750.000 lekësh, nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

27.1. Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës 2004-2007, ka banuar në apartamentin në Pogradec, me adresë Rruga “{***}”, Nd. {***}, H. {***}, Ap. {***}, {***}, së bashku me bashkëjetuesen I. B..

27.2. Furnizuesi i Shërbimit Universal, me shkresën nr. {***} prot., datë 4.2.2021, ka informuar Komisionin se shtetasi Hektor Mushi, sipas sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë furnizimi me energji elektrike. Ndërsa shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” ShA,

Pogradec, me shkresën nr. {***} prot., datë 1.6.2023, informon Komisionin se shtetasi Hektor Mushi është abonent me nr. kontrate {***}, datë 1.7.2005.

27.3. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se shpenzimet lidhur me mobilimin dhe punimet në apartamentin në Pogradec, janë kryer në vazhdimësi ndër vite, që nga viti 2004 e në vazhdim nga ai dhe bashkëjetuesja e tij, nga të ardhurat e pagës, duke përfshirë këtu edhe kontributin familjar të secilit prej tyre.

27.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se në apartament nuk ishin kryer një pjesë e punimeve të brendshme hidraulike, dyert e brendshme dhe punimet elektrike dhe investimet për kryerjet e këtyre punimeve janë kryer në vitet në vazhdim prej tij, deri në vitin 2007, ku vlera e investimit nuk kalonte vlerën e detyrueshme për deklarim për secilin vit.

27.5. Komisioni në pyetësorin nr. 2, dërguar me *e-mail* në datën 12.9.2023, i ka kërkuar subjektit të deklarojë vlerën e këtyre punimeve, si edhe të deklarojë vlerën e mobilimit për këtë apartament. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se pagesat e punimeve të pjesshme të sipërcituara kanë filluar të paguheshin pas vitit 2004, në vazhdimësi deri në vitin 2007 dhe, në total, me sa i kujtohej, vlera e tyre ka qenë rreth 750.000 lekë, por siç ka deklaruar edhe në përgjigjet e datës 5.9.2023 (pyetësori nr. 1), vlera e investimit nuk e ka kaluar vlerën e detyrueshme për deklarim për secilin vit¹. Në këtë vlerë hyjnë dhe mobilimi me orëditë bazike për jetesë normale. Për secilin vit: 2005, 2006 dhe 2007, vlera e investimit ka qenë përafërsisht e njëjtë, rreth 250.000 lekë.

28. Nga krahasimi i deklarimeve të mësipërme, trupi gjykues vëren se, nga njëra anë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament së bashku me bashkëjetuesen e tij, që prej vitit 2004, ndërsa nga ana tjetër deklaroi se në apartament nuk ishin kryer një pjesë e punimeve të brendshme hidraulike, dyert e brendshme dhe punimet elektrike. Ashtu si dhe ka konstatuar Komisioni, lloji i punimeve të deklaruara nga subjekti janë punime të domosdoshme për krijimin e kushteve minimale për banim e, për pasojë, deklarimi i subjektit se vlera e punimeve/mobilimit është e shtrirë gjatë periudhës 2005-2007, nuk duket i besueshëm, pasi bie në kundërshtim me deklaratën e tij që ka filluar të banojë në vitin 2004. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se janë kontradiktore deklaratat e subjektit për gjendjen e karabinës së apartamentit, dhe për punimet e kryera prej tij si punime të brendshme hidraulike, dyert e brendshme dhe punimet elektrike, pasi gjendja e karabinës ka nevojë dhe për shumë punime të tjera shtesë, të cilat do të ishin në një vlerë më të madhe se ajo e deklaruar nga subjekti. Për sa i përket volumit të ndërtimit të një objekti në fazën e karabinasë, Kolegji në disa vendime të tij ka çmuar se në mungesë të një standardi ligjor të mirëpërcaktuar, volumi i punimeve që konsiderohet në fazë karabinaje duhet të jenë në masën 42% të vlerës së objektit dhe pjesa e mbetur prej 58% si volum punimesh për përfundimin e tyre².

¹ Në periudhën në fjalë, 2004-2007, ligji nr. 9049 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, nuk ka pasur një vlerë të përcaktuar për shpenzimet e deklarueshme.

² Shih vendimet e Kolegjit nr. 22/2020 (JR); nr. 35/2021 (JR); nr. 34/2022 (JR); nr. 8/2024 (JR).

29. Në analizë të deklarimeve e shpjegimeve të subjektit të dhëna gjatë hetimit administrativ lidhur me shpenzimet e punimeve dhe të mobilimit, trupi gjykues vëren se duket se këto deklarime synojnë copëzimin/shpërndarjen e këtyre shpenzimeve në vite, në funksion të reduktimit të tyre si shpenzim i vitit 2004, me qëllim përmirësimin e situatës financiare të këtij viti. Për këtë arsye, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion të kohës kryerjen e shpenzimeve për punime dhe mobilim, që do të provonin dhe pretendimet e tij për kryerje shpenzimesh të shtrira në disa vite, kjo mungesë dokumentacioni, së bashku me mungesën e deklarimeve në deklaratat periodike dhe në atë *vetting*, apo të indicieve të tjera, i bëjnë të pabesueshme deklaratimet e subjektit, të cilat duket se janë bërë me synimin për të ulur rezultatin negativ financiar. Sa më sipër, mbetet i bazuar qëndrimi i Komisionit, i cili ka konsideruar si shpenzime (mobilimi) vlerën prej 750.000 lekësh, të kryer si shpenzim në vitin 2004, viti i fillimit të banimit në apartament.

Lidhur me burimin e krijimit të apartamentit

30. Si burim për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar: *një pjesë të dhuruar nga vëllai im A. P. (M.), të fituara nga puna e tij si emigrant në atë kohë në Gjermani dhe dhurata nga familjarët e mi, miq, të ftuar dhe familjarët e bashkëjetueses sime. Këto dhurata në para, më janë dhuruar me rastin e ceremonisë të martesës me bashkëjetuesen time I. B., zhvilluar më dt. 21.12.2003. Gjithsej, në total 1.500.000 lekë. Pjesa tjetër, prej 500.000 lekësh, e pjesës së mbetur të çmimit të blerjes së banesës, është plotësuar nga kursimet e mia prej pagës si prokuror në atë kohë në Prokurorinë e Rrethit Pogradec³.*
31. Komisioni, në kushtet kur subjekti ka deklaruar se për blerjen e apartamentit ka kontribuar vëllai i tij, A. P. (M.), dhe ky shtetas konfirmon kontributin e tij, bazuar në pikën 14 të nenit 3, dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, e ka konsideruar vëllain “person tjetër i lidhur” me subjektin e rivlerësimit, për të cilin subjekti ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar, në vlerën 1.500.000 lekë. Në përfundim të analizës së të ardhurave dhe shpenzimeve të vëllait të subjektit, Komisioni ka konstatuar se të ardhurat e këtij shtetasi për periudhën 01.08.1995 – 21.01.2004, në total 47.030 euro, nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës në shumën 78.248 euro, duke konkluduar se personi tjetër i lidhur A. P. (M.) nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për t’i dhuruar shumën 1.500.000 lekë subjektit të rivlerësimit.
32. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se vëllai nuk ka pasur burime të ligjshme për t’i dhuruar këtë shumë. Sipas tij, Komisioni ka bërë përllogaritje të gabuara të shpenzimeve të jetesës së vëllait si student në Gjermani, pasi është bazuar në të dhënat e Eurostat, ndërkohë që kjo llogaritje duhej të ishte bërë sipas ligjit federal gjerman mbi ndihmën për financimin e studimeve (Ligjit Bafög), sipas të cilit për periudhën 01.08.1995 - 21.01.2004, shpenzimet e llogaritura janë 37.628 euro, dhe jo 78.248 euro, sipas llogaritjes nga Komisioni. Po

³ Në ndryshim nga deklarata *vetting*, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se ka marrë dhuratë nga vëllai i tij A. P. (M.) vlerën prej 1.500.000 lekësh, për blerjen e apartamentit, pra nuk përfshin në këtë shumë dhuratat në para të deklaruara më parë.

ashtu, subjekti pretendon për të ardhura të kësaj periudhe më të larta se Komisioni, në vlerën prej 55.228 eurosh dhe jo 47.030 euro si Komisioni, dhe konkludon se me këto të ardhura, duke zbritur shpenzimet, vlera prej 17.600 eurosh justifikon kontributin për mbulimin e vlerës së apartamentit prej 1.500.000 lekësh ose 11.223 euro.

33. Me qëllim analizimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues verifikoi aktet e sjella prej tij në Komision, nga ku rezultoi se:

33.1. Subjekti ka paraqitur bashkë me deklaratën *vetting*, letrën sqaruese të datës 24.01.2017, të vëllait të tij, A. P. (M.), ku ky i fundit, lidhur me burimin e shumës së dhuruar, ka deklaruar se: *Këto para e kanë burimin kryesisht nga punësimi im me kohë të plotë në restorantin “{***}”, Munihi, gjatë periudhës 1.8.1995 - 14.12.1996, si dhe punësimi nga data 20.7.1998 - 31.10.1998, te firma {***}, po në Munihi. Po ashtu, edhe punësime të ndryshme gjatë kohës së studimeve në Gjermani (1998-2006).*

33.2. Në deklaratën *vetting*, si dhe në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka paraqitur vërtetim nga sigurimet shoqërore të shtetit gjerman për A. P., për të ardhurat e realizuara gjatë periudhës 1.8.1995 - 31.12.2006 (sjellë në përgjigje të pyetësorit standard në formën e kërkuar ligjore, me vulë apostile, i përkthyer dhe i noterizuar).

33.3. Sipas procesverbalit të datës 28.7.2011, të ILDKPKI-së, në përgjigje të pyetjes lidhur me burimin e blerjes së apartamentit, subjekti është përgjigjur se: *burimet financiare për blerjen e këtij apartamenti janë siguruar nga të ardhurat e mia të mbledhura në formën e dhuratës martesore në raport 1/3 e vlerës, dhe 2/3 është paguar nga vëllai im A. A. M., i cili aktualisht banon në Gjermani, dhe për vërtetimin e këtij fakti pranë firmës së ndërtimit “{***}” ShPK, janë të gjitha faturat e pagesave të kryera. Në dokumentacionin e dorëzuar në ILDKPKI nga subjekti, konstatohen 3 mandatar-këtime të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas të cilave rezulton se shtetasi A. M. ka kryer këto arkëtime: (i) shuma 500.000 lekë sipas mandatar-këtimit nr. {***}, datë 26.3.2003; (ii) shuma 500.000 lekë sipas mandatar-këtimit nr. {***}, datë 27.5.2003; (iii) shuma 500.000 lekë sipas mandatar-këtimit nr. {***}, datë 21.1.2004. Në këto mandate, në cilësinë e kryellogaritarit, ka nënshkruar shtetasi F. H., ndërsa mungon nënshkrimi i personit që ka kryer derdhjen e shumave.*

34. Komisioni ka marrë në konsideratë të ardhurat e realizuara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit nga punësimi në Gjermani, bazuar në dokumentin e paraqitur nga vetë subjekti, vërtetim nga sigurimet shoqërore për të ardhurat e realizuara gjatë periudhës 1.8.1995 – 31.12.2006, të cilat, sipas përlllogaritjeve nga Komisioni, janë në vlerën 47.030 euro. Subjekti ka pretenduar dhe të ardhura të tjera nga bakshishet dhe punë të tjera të kryera nga i vëllai në vite, duke paraqitur në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, edhe disa akte në mbështetje të këtyre pretendimeve, si: kontratë pune si përkthyes (që është një kontratë tip, që nuk ka as datë, emra dhe as nënshkrim të palëve), kopje kontrate punësimi në tavernën në pronësi të kushërirës, dokumentacion për përfitimin e bursës, por që janë akte të papërkthyer dhe të palegalizuara dhe, si të tilla, Komisioni nuk u ka dhënë vlerë provuese.

35. Në rastin e llogaritjes së mundësisë financiare të vëllait të subjektit për të dhuruar shumën 1.500.000 lekë, problematika, sipas subjektit të rivlerësimit, konstatohen dhe në llogaritjen e

shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë. Ndërsa Komisioni llogaritjen e shpenzimeve të jetesës e ka bërë bazuar në të dhënat e Eurostat-it, subjekti i rivlerësimit pretendon që këto shpenzime, për shkak të statusit të vëllait si student, duhet të llogariten sipas Ligjit Bafög (ligjit federal mbi ndihmën për financimin e studimeve)⁴. Sipas subjektit, këto shpenzime duhet të jenë në vlerën 37.628 euro, dhe jo 78.248 euro, sipas llogaritjes nga Komisioni. Subjekti pretendon se për periudhën tetor 1997 – janar 2004, duhet të merren për bazë kostot e jetesës së një studenti të huaj në Gjermani, si dhe të merren parasysh nevojat dhe kërkesat e një studenti që vinte nga vendi më i varfër i Evropës.

36. Trupi gjykues vëren se janë të pabazuara argumentet e subjektit se vëllai i tij ka pasur kosto jetese më të ulët se studentët e tjerë, në kushtet kur ai nuk paraqet asnjë lloj dokumentacioni provues në kuadër të pretendimeve të tij se vëllai ka banuar në banesën që i përkiste punëdhënësit, apo që ka ndarë shpenzimet e ushqimit dhe kostot e tjera me studentë të tjerë. Sa i takon standardit të përdorur për llogaritjen e shpenzimeve, konstatohet se Ligji Bafög, që referon subjekti, u referohet standardeve të jetesës vetëm për studentët, duke konsideruar faktin që ata nuk janë të punësuar, por që nuk është rasti i vëllait të subjektit, i cili rezulton se ka pasur punësim të vazhdueshëm, duke u përfshirë në këtë mënyrë në kategorinë e personave me të ardhura, qoftë dhe të pakta, dhe që trajtohen sipas standardeve të Eurostat-it.
37. Kolegji, referuar pretendimit të subjektit se vëllai ka qenë student dhe shpenzimet e jetesës kanë qenë më të ulëta, si alternativë iu referua edhe informacionit në burimet zyrtare të statistikave të Gjermanisë⁵ për kategoritë kryesore të shpenzimeve⁶ për familje me 1 person. Sipas analizës së kryer në Kolegj, në bazë të këtyre të dhënave, rezulton se shpenzimet e jetesës së vëllait të subjektit A. P. (M.), për periudhën gusht 1995 - janar 2004, janë në vlerën prej 50.802 eurosh, në ndryshim nga vlera 78.248 euro, që ka konkluduar Komisioni. Por, konstatohet se të ardhurat e vëllait prej 47.030 eurosh (të konsideruara në analizë në rezultatet e hetimit nga Komisioni për periudhën 01.08.1995 - 21.01.2004), nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës prej 50.802 eurosh, të rishikuara në Kolegj. Për rrjedhojë, personi tjetër i lidhur, vëllait i subjektit A. P. (M.), nuk justifikon me të ardhura të ligjshme përballimin e shpenzimeve të jetesës dhe krijimin e kursimeve, në vlerën 1.500.000 lekë, të dhuruara subjektit për blerjen e apartamentit në Pogradec.

⁴ https://www.gesetze-im-internet.de/baf_g/_13.html

⁵ Burimi nga faqja e statistikave të Gjermanisë, “Destatis, Statistisches Bundesamt” [https://www.destatis.de/EN/About-Us/_node.html].

Përkatësisht:

<https://www.genesis.destatis.de/genesis/online?operation=themes&levelindex=0&levelid=1719299734384&code=63#abreadcrumb>; <https://www.genesis.destatis.de/genesis/online?operation=abruftabelleBearbeiten&levelindex=1&levelid=1718893676632&auswahloperation=abruftabelleAuspraegungAuswaehlen&auswahlverzeichnis=ordnungstruktur&auswahlziel=werteabruf&code=63221-0002&auswahltext=&werteabruf=Werteabruf#abreadcrumb>

⁶ Ushqime, pije, produkte duhani; Veshje dhe këpucë; Kujdesi shëndetësor; Posta dhe telekomunikacioni; Arsimi; dhe nuk përfshin të tjera COICOPS apo kategori shpenzimesh, si: Strehimi, energjia dhe mirëmbajtja e banesave; Pajisje të brendshme, pajisje shtëpiake dhe artikuj; Trafiku; Koha e lirë, argëtimi dhe kultura; Shërbimet e akomodimit dhe hotelierisë; Mallra dhe shërbime të tjera.

38. Gjithashtu, trupi gjykues, nga aktet, konstaton se vëllai i subjektit ka përfituar bursë si student, për periudhën shtator 2001 - janar 2004, në vlerën 5.400 euro⁷. Sipas qëndrimit të Kolegjit⁸: *Bursa akordohet si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese pa përfshirë luksin. Një ndër arsytet për të cilat edhe studentët punojnë gjatë qenies në universitet, është për shkak të përballimit të shpenzimeve, për të cilat nuk është e mundur të përballohen vetëm me bursën e akorduar nga universiteti.* Fakti i përfitimit të bursës, që u jepet studentëve që arrijnë të vërtetojnë se kanë të ardhura të pakta, tregon për një situatë financiare jo të mirë të vëllait të subjektit të rivlerësimit, duke kundërshtuar pretendimet e subjektit se ai kishte mundësi për të krijuar kursime nga puna si student dhe, për më tepër, t’ia dhuronte ato vëllait që ishte i punësuar prej vitesh në Shqipëri dhe kishte të ardhura të qëndrueshme dhe të mjaftueshme sipas standardit shqiptar. Edhe në rast se do të konsiderohej se vëllai i subjektit ka arritur të krijojë disa kursime minimale, trupi gjykues çmon se mbetet i pabesueshëm fakti i dhurimit të këtyre kursimeve vëllait të tij për blerjen e një apartamenti, që nuk mund të konsiderohet si një situatë emergjence apo nevojë jetësore e që do të justifikonte një veprim të tillë, sikurse mund të mendohet për vëllain student, duke i mohuar çdo të drejtë vetes për të gëzuar kursimet, sado të pakta, të punës së tij.
39. Sa më sipër, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin se personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit, A. P. (M.), nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për t’i dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën 1.500.000 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 1.732.497⁹, për blerjen e pasurisë apartament në Pogradec, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Për apartamentin me sipërfaqe 112 m² në Elbasan (në përdorim të subjektit, në pronësi të nënës së tij)

40. Në deklaratën vetting 2017, personi i lidhur, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. F. M., ka deklaruar: *Pronare me certifikatë për vërtetim pronësie e një apartamenti me sip. 112 m², në lagjen “{***}”, Elbasan, me nr. pasurie {***}, në zonën kadastrale nr. {***}, Elbasan.* Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi të kësaj pasurie, nëna e subjektit ka deklaruar kursimet e saj dhe të bashkëshortit të ndjerë, si dhe kredinë e marrë nga djali Hektor Mushi.
41. Komisioni, lidhur me këtë pasuri, ka konkluduar se personi i lidhur, nëna e subjektit të rivlerësimit, ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën prej 1.482.311 lekësh për pagesën e kështit të parë, në datën 11.12.2006, për blerjen e apartamentit në Elbasan.

⁷ Në aktet e paraqitura, “Vërtetim bursa dokumenti nr. {***}”, evidentohen kreditime në llogari prej 1.000 eurosh (në datat 31.03.2003, 02.07.2003, 23.04.2003 dhe 29.04.2003), të cilat potencialisht mund të konsiderohen si të ardhura kur vlerësohet diferenca të ardhura – shpenzime jetese.

⁸ Shih vendimin e Kolegjit nr. 9/2018 (JR), prg. 81.

⁹ Sipas analizës së kryer në Kolegj, konstatohet se ka një diferencë prej 120.001 lekësh më shumë nga vlera 1.612.496 lekë e Komisionit. Diferenca vjen pasi në Komision nuk janë konsideruar balanca e likuiditetit në ProCredit Bank të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, I. B., sjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 05.02.2021, nga banka, ku rezulton se ka pasur likuiditet të krijuar gjatë vitit 2004, me gjendje në fund të vitit 2004 prej 120.001 lekësh.

42. Gjithashtu, Komisioni, në kushtet kur ka konstatuar se: (i) subjekti i rivlerësimit ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme përdorimi të apartamentit që nga momenti i ndërtimit të tij; (ii) nëna e subjektit është transferuar në apartamentin ku banon subjekti në prill 2014, pas vdekjes së babait të subjektit; (iii) emri i subjektit figuron në listën emërore të banorëve të paraqitur më datë 28.1.2009, nga investitori pranë UK Elbasan; (iv) kontrata e furnizimit me ujë është lidhur në emër të subjektit (jo të prindërve); (v) subjekti ka kontribuar në shumën 2.500.000 lekë për blerjen e këtij apartamenti, por nuk figuron të ketë të drejta pronësie; (vi) subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime mbi rrethanat e konstatuara në barrën e provës, rrethana që shoqërohen me mungesën e burimeve të ligjshme financiare të prindërve të tij për pagesën e këstit të parë në shumën 1.482.311 lekë – ka çmuar se krijohen dyshime të arsyeshme se pasqyrimi i emrit të babait të subjektit në kontratën e porosisë së datës 11.12.2006, e më pas i emrit të nënës së tij në kontratën e shitjes me kusht të datës 17.12.2014, bashkë me deklarinin në deklaratën *vetting* të së drejtës së banimit të tij dhe të pronësisë së nënës, janë veprime në funksion të fshehjes së të drejtës së pronësisë së subjektit të rivlerësimit mbi apartamentin e sipërcituar, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
43. Në përfundim, në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka çmuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit se ka vetëm të drejta banimi dhe deklarimi nga personi i lidhur F. M., në deklaratën *vetting*, i së drejtës së pronësisë për apartamentin me sip. 112 m², Elbasan, nuk bindin për vërtetësinë e tyre dhe, për rrjedhojë, Komisioni e ka vlerësuar sjelljen e subjektit si përpjekje për të fshehur pasurinë në emër të prindërve, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
44. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, parashtroi se prindërit e tij kanë pasur burime të ligjshme financiare për të kryer pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit në shumën 3.000.000 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë në analizën financiare të ardhurat nga punësimi i babait në shoqërinë “{***}” ShPK, për periudhën 01.02.1995 - 31.12.1997.
45. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit në Elbasan nga prindërit, ka ndihmuar dhe dhënia e huasë në shumën 10.000 euro për vëllain D. M. nga kushërira T. L. (D.), hua e cila dokumentohet dhe është e ligjshme. Subjekti i rivlerësimit kundërshton dhe konkluzionin e Komisionit për fshehje të pronësisë mbi këtë apartament në emër të prindërve, pasi ai e ka deklaruar këtë pasuri si vendbanim në mënyrë të përsëritur në ILDKPKI, në deklarinimet periodike vjetore, si dhe në deklaratën *vetting*. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontributin financiar për blerjen e këtij apartamenti nëpërmjet kredisë bankare, dhe kjo pasuri nuk mund të kualifikohet si një pasuri e fshehur për sa kohë që ekzistenca, pronësia e nënës dhe përdorimi prej tij i apartamentit është deklaruar saktë në deklarinimet periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*.
46. Subjekti i rivlerësimit pretendon dhe se Komisioni, në mënyrë të gabuar dhe të kundërligjshme, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, i ka kaluar barrën e provës për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të babait, ndërkohë që babai i tij, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka qenë as në cilësinë e dhuruesit dhe as në atë të huadhënësit.

47. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, nga analiza e dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si në vijim.

Lidhur me përdorimin nga subjekti të apartamentit

48. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*, në seksionin “Vendqëndrim tjetër, adresa e plotë e banimit”, adresën: *Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, pallati i {***}, kati i {***} banim, Elbasan*, që i korresponдон apartamentit me sipërfaqe 112 m², në pronësi të nënës së tij. Ndërsa, si adresë të gjendjes civile, në deklaratën *vetting*, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në deklaratat periodike të viteve 2005 – 2016, subjekti ka deklaruar apartamentin e prindërve, përfituar nga privatizimi.
49. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, rezulton se adresën e apartamentit në pronësi të nënës, subjekti e ka deklaruar si adresë tjetër banimi dhe në deklaratat periodike vjetore të viteve 2010, 2012 dhe 2016.
50. Në përgjigje të pyetësorit standard dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Nga viti 2008 dhe deri më sot, kam në përdorim pa shpërblim shtëpinë në pronësi të nënës sime, ku jetoj aktualisht me bashkëjetuesen I. B., vajzën G. M., së bashku me nënën time F. M., me adresë: Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Nd. {***}, H. {***}, Ap. {***}, Elbasan.*
51. Lidhur me situatën faktike të përdorimit prej shumë vitesh të apartamentit në pronësi të nënës, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie përdorimi në deklaratën *vetting*, në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën jepet përkufizimi se: *Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.* Ky përkufizim, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, detyronte subjektin e rivlerësimit të deklaronte përdorimin e këtij apartamenti si një pasuri në përdorim në momentin e dorëzimit të deklaratës vetting, në datën 30.01.2017.* Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shkelur detyrimet ligjore, duke mos deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë përdorimin e apartamentit, dhe nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm vetëm deklarimi si adresë banimi, siç ai pretendon.

Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë apartament

52. Komisioni ka analizuar burimet e krijimit të apartamentit, bazuar në deklaratimet e personit të lidhur, nënës së subjektit të rivlerësimit, se si burim për blerjen e tij kanë shërbyer kursimet e saj dhe të bashkëshortit të ndjerë, që janë përdorur për pagesën e kështit të parë, si dhe kredia e marrë nga djali Hektor Mushi, që ka shërbyer për pagesën e kështit të dytë.

53. Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për pagesën e kështit të parë prej 3.000.000 lekësh, janë përdorur kursimet e prindërve të mbledhura ndër vite. Ndërsa në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 29.02.2016, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e prindërve, kursimet nga puna e babait si inxhinier deri dy vjet para vdekjes, si dhe dërgesat e vëllezërve nga Gjermania.
54. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se vëllezërit kanë kontribuar në kursimet e përdorura për pagesën e kështit të parë, por nuk ka specifikuar vlerën e këtij kontributi. Më tej, subjekti ka shpjeguar se një pjesë të këtyre të ardhurave, konkretisht një shumë prej 10.000 eurosh, vëllai i tij D. M. e ka marrë hua nga kushërira e tyre, T. L. (D.), me nënshtetësi gjermane. Këtë hua, vëllai D. M. ia ka dhënë babait për pagesën e kontratës së porosisë, ndërsa huanë e ka shlyer vetë deri në vitin 2021, nga të ardhurat e tij personale.
55. Në kontratën e sipërmarrjes të datës 11.12.2006, të lidhur ndërmjet shtetasve V. K. dhe A. M., pasqyrohet se kësti i parë për blerjen e apartamentit, në vlerën prej 3.000.000 lekësh, paguhet me lidhjen e kontratës dhe deklarohet i marrë nga sipërmarrësi. Sipas kontratës së shitjes me kusht nr. {***}, datë 17.12.2014, midis shtetasit V. K., në cilësinë e palës shitëse, dhe F. M., në cilësinë e palës blerëse, çmimi i shitjes është 5.510.400 lekë dhe ky çmim paguhet me dy këste: (i) kësti i parë prej 3.010.400 lekësh është likuiduar nga ana e blerësit; (ii) kësti i dytë prej 2.500.000 lekësh do të likuidohet pas disbursimit të kredisë bankare, marrë nga subjekti pranë Bankës Societe Generale Albania, e cila do të kalohet në llogarinë e noteres e më pas do t'i transferohet shitësit.

Burimet e kështit të parë prej 3.000.000 lekësh

56. Sipas burimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në aktet e cituara më sipër, trupi gjykues në vijim do të shqyrtojë shkaqet e ankimit mbi mundësitë financiare të vëllezërve për pagesën e kështit të parë, si dhe mbi të ardhurat e babait të subjektit nga punësimi në një subjekt privat.
57. Trupi gjykues vëren se Komisioni ka kryer analizën lidhur me mundësinë financiare të vëllezërve për të kontribuar në pagesën e kështit të parë prej 3.000.000 lekësh, të kryer më datë 11.12.2006, kur është lidhur kontrata e porosisë, sipas së cilës ka rezultuar se njëri prej vëllezërve, shtetasi A. P. (M.) nuk ka pasur mundësi të kontribuojë në pagesën e këtij kështi, pasi të ardhurat e tij bruto, për periudhën shkurt 2004 - dhjetor 2006, prej 9.694 eurosh, nuk mbulojnë shpenzimet prej 28.337 eurosh për këtë periudhë.
58. Ndërsa, për sa i përket kontributit të vëllait tjetër D. M., me një hua prej 10.000 eurosh të marrë nga kushërira e tij T. L. (D.), Komisioni ka konstatuar se ky burim është deklaruar për herë të parë në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 27.07.2023, ndërkohë që subjekti dhe personi i lidhur, nëna e tij, i kanë pasur të gjitha mundësitë që ta shpjegonin këtë situatë në deklaratën *vetting*, sipas kërkesave ligjore lidhur me deklarimin e burimit. Për rrjedhojë, kjo hua e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, nuk është konsideruar nga Komisioni si burim për pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit.

59. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit ankimon vetëm konkluzionin e Komisionit për sa i përket mundësisë financiare të vëllait D. M. për të ndihmuar prindërit në pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit, prandaj analiza në vijim është vetëm lidhur me këtë konkluzion.

60. Sa i përket kontributit të vëllait të subjektit D. M., me huanë prej 10.000 eurosh të marrë prej tij, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni konstatohet se:

60.1. Në pyetësin nr. 1, kërkesës për të saktësuar dërgesat e vëllezërve nga Gjermania, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: *Konfirmoj se dërgesat e vëllezërve nga Gjermania kanë qenë një pjesë e kursimeve të përdorura për pagesën e këstit të parë. Një pjesë të këtyre të ardhurave, vëllai im D. M. i ka marrë hua nga kushërira ime T. L. (D.), vajza e hallës, me nënshetësi gjermane, shumë e cila ishte 10000 euro. Këtë hua vëllai im D. M. ia ka dhënë babait për pagesën e kontratës së porosisë, si dhe huanë e ka shlyer deri në vitin 2021, nga të ardhurat e tij personale. Bashkëngjitur dokumentet në gjuhën gjermane, të përkthyer dhe me vulë apostile, të deklarimeve të T. L. (D.) dhe të të ardhurave të saj personale, si dhe të të ardhurave të vëllezërve të mi.*

60.2. Bashkë me përgjigjet e pyetësit, në cilësinë e provës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision: (i) dokumentacion lidhur me të ardhurat e realizuara nga vëllai D. M., për periudhën 26.8.2003 – 31.12.2022; (ii) dokumentacion lidhur me të ardhurat e realizuara nga shtetasja T. L. (D.) për periudhën 20.5.1994 – 31.12.2010; (iii) deklaratë e datës 11.8.2023, e shtetasës T. L. (D.) për dhënie huaje.

60.3. Në përgjigjet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit u është referuar deklarimeve të vëllait, i cili ka pretenduar se në deklarinë e tij në deklaratën *vetting*, nuk e kishte të qartë qëllimin e pyetësit dhe në çfarë detaji duhej të përgjigjej, duke shtuar se në vitin 2017, përgjigjet e tij u bënë në funksion të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive të krijuara. Periudha për huamarrjen është viti 2006, 11 vite para se të plotësonte deklaratën, ndërkohë që udhëzimi i shtetit gjerman është të ruash dokumente financiare për një periudhë prej 10 vjetësh. Gjithashtu, vëllai ka sqaruar se huaja nga kushërira nuk është përmendur, për shkak se: (i) ishte një huadhënie informale mes njerëzve familjarë shumë të afërt; (ii) dokumenti që dëshmonte huamarrjen, i krijuar në vitin 2023, ka dashur një kohë të konsiderueshme për t'u hartuar, duke përfshirë vizita të shumta në zyra të ndryshme publike dhe noterësh, për të dhe kushërirën, duke përfshirë marrjen e disa ditëve pushimi nga puna; (iii) pjesa më e madhe e huasë ishte paguar në vitin 2017, pasi gjatë kësaj kohe ai kishte filluar të punonte me kohë të plotë dhe se qëllimi i një pjese të kredisë në Deutsche Bank, prej 5.000 eurosh, ishte shlyerja e kësaj huaje; (iv) nuk e ka përcaktuar këtë huadhënie si të rëndësishme për pyetësin, pasi ishte hua nga një pjesë e familjes dhe jo pasuri; (v) për të njëjtën arsye nuk i ka listuar në pyetësor si burime pasurie paratë që i kanë dërguar prindërit gjatë viteve për ta ndihmuar me studimet; (vi) për të njëjtën arsye, nuk ka listuar në vitin 2017 ose në vitin 2023, ndihmat financiare që u ka dhënë prindërve; (vii) kjo huamarrje nuk ka lidhje me vëllain Hektor Mushi.

60.4. Bashkëlidhur prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision aktet: (i) dokument në formatin *Word*, me emërtim “Aneksi 1 D. M.”; (ii) dokument në formatin *Excel*, me emërtim “Aneksi 2 D. M.”; (iii) dy foto dokumentesh në gjuhën gjermane, njëri me emërtim “*Lohnsteurkarte 2006*” dhe tjetri nga Deutsche Bank.

61. Komisioni ka konkluduar se kjo hua nuk mund të konsiderohet si burim për pagesën e parë për shkak të momentit kur është bërë deklarimi i marrjes së huasë, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, më datë 27.07.2023, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, nëna e tij, mund dhe duhet ta kishin deklaruar në deklaratën *vetting*, si burim për pagesën e kështit të parë të apartamentit. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, në ankim, prapëson se huaja e dhënë, e cila ka ndihmuar në pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit, është e dokumentuar dhe e ligjshme.
62. Nga aktet, rezulton se në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur dokumentin vërtetim huaje të datës 11.08.2023, në gjuhën gjermane, sipas përkthimit të të cilit shtetasja gjermane T. L. (D.) deklaron se *i ka dhënë në vitin 2006, kushëririt të saj D. M., një shumë prej 10.000 eurosh. D. M. vërteton se shumën e marrë hua atëherë e ka përdorur duke ia dhënë babait të tij A. M., i cili është xhaxhai im, që është ndihmuar të blejë një banesë. Kjo shumë është paguar në vitet pasardhëse [...]. Kësti i fundit ka qenë në vitin 2021. Ky vërtetim, nënshkrimi i të cilit vërtetohet nga noteri gjerman, është sjellë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe me vulë apostile.*
63. Trupi gjykues vëren se vërtetimi i cituar më sipër, është hartuar dhe paraqitur në Komision pas dërgimit të pyetësorit nr. 1, në të cilin i është kërkuar subjektit të saktësojë dërgesat e të ardhurave nga vëllezërit në Gjermani. Trupi gjykues vëren se për vetë momentin kur është hartuar dhe depozituar ky dokument, nuk arrin të provojë si bindëse deklaratimet e dhëna nga palët, pasi rezulton se është një akt i hartuar në funksion të procesit të rivlerësimit, për të mbështetur deklaratimet e subjektit. Në kushtet kur: (i) huaja nuk është dokumentuar me akte provuese të kohës kur është dhënë, në vitin 2006; (ii) nuk është deklaruar në deklaratën *vetting* si burim i blerjes së apartamentit; dhe (iii) është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë hetimit administrativ, vërtetimi/formalizimi i mëvonshëm i dhënies së saj nuk mund të ketë vlerë provuese bindëse në procesin e rivlerësimit. Në këtë rast, sillen në vëmendje qëndrimi i Kolegjit se deklaratat e paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit nuk kanë efekt provues në këtë proces, nëse nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit. Vlera provuese e këtyre deklaratave çmohet nga trupi gjykues rast pas rasti, në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklaratimeve të dhëna në to me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision dhe atij në Kolegj¹⁰.
64. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar qëndrimi i Komisionit për të mos e konsideruar huanë 10.000 euro si burim për pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit.
65. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka analizuar dhe të ardhurat e realizuara në Gjermani nga shtetasi D. M., sipas dokumentacionit të paraqitur gjatë hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit. Nga kjo analizë e Komisionit, ka rezultuar se të ardhurat bruto gjatë periudhës 26.8.2003 – 31.12.2006, kanë qenë në vlerën 21.687 euro, ndërkohë që për të njëjtën periudhë, shpenzimet e jetesës për 1 person kanë qenë në vlerën 32.474 euro, duke sjellë konkluzionin se vëllai i subjektit, z. D. M., nuk ka pasur mundësi financiare për të kontribuar në pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit.

¹⁰ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR); nr. 11/2019(JR); nr. 34/2019 (JR); nr. 28/2021(JR).

66. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, kundërshton konkluzionet e Komisionit për pamundësinë financiare të vëllait D. M. për të kontribuar në pagesën e kështit të parë, duke pretenduar se vëllai, me të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera, ka disponuar likuiditete për shlyerjen e huasë. Trupi gjykues vëren se ky pretendim i subjektit shkon përtej asaj që ka konkluduar Komisioni, i cili ka analizuar vetëm periudhën 26.08.2003 – 31.12.2006, për mundësinë financiare për pagesën e kështit të parë, dhe jo mundësinë e shlyerjes së huasë, që subjekti pretendon se është shlyer deri në vitin 2021 nga të ardhurat personale të vëllait.
67. Lidhur me mundësinë financiare të vëllait, subjekti i rivlerësimit kundërshton në Kolegj llogaritjen e shpenzimeve nga Komisioni, duke pretenduar se këto shpenzime kanë qenë në vlerën 20.792 euro dhe jo në vlerën 32.474 euro, siç ka konkluduar Komisioni. Trupi gjykues vëren se subjekti pretendon që standardi që duhet të ndiqet për llogaritjen e shpenzimeve për vëllain D. M., duhet të bazohet në studimin “Die Studierendenbefragung in Deutschland”, ndërkohë që për vëllain tjetër ka pretenduar aplikimin e standardit sipas Ligjit Bafög, dhe është e paqartë se përse subjekti përdor dy referenca të ndryshme, për kushte të njëjta të vëllezërve të tij si studentë, dhe për periudha të afërta kohore.
68. Sa u përket pretendimeve të subjektit për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës së vëllait D. M., trupi gjykues vëren se subjekti, si në Komision, ashtu dhe në ankimin drejtuar Kolegjit, paraqet referencat të cilat i cilëson më të sakta për llogaritjen e kostove të jetesës për studentët në Gjermani, duke iu referuar studimeve të trendeve për situatën jetësore dhe studimore në Gjermani¹¹, sipas të cilave, shpenzimet e jetesës për periudhën 26.8.2003 – 31.12.2006, kanë qenë 20.792 euro. Ndërsa Komisioni ka konsideruar si shpenzime jetese, për 1 person në Gjermani, shumën 32.474 euro, referuar të dhënave statistikore nga Eurostat¹².
69. Në Kolegj, u konsiderua si alternativë në analizën e të ardhurave të vëllait, raporti i statistikave të Gjermanisë¹³ për *Shpenzimet e konsumit final të familjeve private në Gjermani*, për raportin e shpenzimeve mesatare mujore për familjet dhe qëllimet e shpenzimeve, për familje me 1 person, nga e cila rezultoi se shpenzimet e jetesës për familje me një person, për kategoritë kryesore të shpenzimeve, për periudhën 26.08.2003 – 31.12.2006, për vëllain e subjektit D. M., do të ishin 23.822 euro. Konstatohet se të ardhurat e vëllait prej 21.687 eurosh, të konsideruara në analizën e Komisionit për periudhën 26.8.2003 - 31.12.2006, nuk mbulojnë totalisht shpenzimet e jetesës prej 23.822 eurosh të rishikuara në Kolegj për shpenzime jetese për familje me një person për kategoritë kryesore të konsumit.

¹¹ Studimi “Die wirtschaftliche und soziale Lage der ausländischen Studierenden in Deutschland 2016” / “Gjendja ekonomike dhe sociale e studentëve të huaj në Gjermani 2016”.

¹² https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_7282795/default/table?lang=en

¹³ Burimi nga faqja e statistikave të Gjermanisë, “Destatis, Statistisches Bundesamt” [<https://www.destatis.de/EN/About-Us/node.html>].

Përkatësisht:

<https://www.genesis.destatis.de/genesis/online?operation=themes&levelindex=0&levelid=1719299734384&code=63#abreadcrumb>; <https://www.genesis.destatis.de/genesis/online?operation=abruftabelleBearbeiten&levelindex=1&levelid=1718893676632&auswahloperation=abruftabelleAuspraegungAuswaehlen&auswahlverzeichnis=ordnungssstruktur&auswahlziel=werteabruf&code=63221-0002&auswahltext=&werteabruf=Werteabruf#abreadcrumb>

70. Gjithashtu, referuar akteve në dosjen e Komisionit, trupi gjykues vëren se gjatë periudhës qershor - korrik 2006, prindërit e subjektit i kanë dërguar vëllait të subjektit D. M., shumë prej 2.500 eurosh për pagesën e studimeve, sipas përshkrimit të tre transfertave në llogarinë bankare në Bankën ProCredit. Konstatohet se këto transferta janë bërë në të njëjtën periudhë në të cilën, sipas deklarimeve të subjektit, vëllai i tij D. M. ka marrë huanë 10.000 euro për të ndihmuar prindërit për pagesën e kështit të parë të apartamentit. Pra, ndërsa vëllai merrte hua për të ndihmuar prindërit, njëkohësisht këta të fundit i dërgonin atij euro për të përballuar studimet/jetesën. Këto rrethana përjashtuese të njëra-tjetrës, krijojnë bindjen se vëllai i subjektit realisht nuk ka pasur mundësi financiare për të përballuar studimet as me të ardhurat e krijuara nga puna e tij, çka ka detyruar prindërit ta mbështesin nga Shqipëria, fakt që i bën të pabesueshme deklaratimet e mëvonshme të tij dhe të subjektit se ai ka ndihmuar financiarisht prindërit për blerjen e një apartamenti të dytë banimi.
71. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mbeten të paprovuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se vëllai i tij D. M. ka ndihmuar prindërit për pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit.
72. Sa u takon *të ardhurave nga pagat e babait të subjektit të rivlerësimit, pranë shoqërisë “{***}” ShPK*, të deklaruara si burim për pagesën e kështit të parë të apartamentit, Komisioni ka çmuar se këto të ardhura mund të jenë krijuar në kuadër të një marrëdhënieje informale punësimi dhe, për rrjedhojë, edhe në eventualitetin që do të provohej krijimi i tyre, ato nuk mund të vlerësohen të ardhura të ligjshme, duke u përfshirë në analizën financiare, për sa kohë nuk përmbushin standardin e përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
73. Subjekti i rivlerësimit në ankim prapëson, duke pretenduar se nuk mund të mohohet paga e marrë për periudhën 1995-1997, meqenëse në zyrat e institucioneve shtetërore nuk ekziston listëpagesa, dhe për këtë arsye nuk mund të penalizohen prindërit në analizën financiare për mungesë të të ardhurave. Sipas deklaratës noteriale të datës 09.12.2005, tregohet për lidhjen që ka pasur babai i tij në një marrëdhënie pune dhe mirëbesimi me shoqërinë “{***}” ShPK. Bazuar në këto fakte, subjekti kërkon përfshirjen në analizën financiare minimalisht të të ardhurave nga paga për periudhën 01.02.1995 - 31.12.1997, në vlerën prej 1.575.000 lekësh.
74. Nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se në deklaratën *vetting*, personi i lidhur, nëna e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: *Paga e bashkëshortit tim të ndjerë në firmën private “{***}” ShPK, si inxhinier mekanik nga data 1.2.1995 deri më 30.10.2001, me pagë mujore 45.000 lekë, në vlerën 3.645.000 lekë*. Bashkëlidhur deklaratës është paraqitur vërtetimi i datës 18.10.2016, nga shoqëria “{***}” ShPK, që konfirmon se shtetasi A. M. ka qenë punonjës pranë kësaj shoqërie, me profesion inxhinier mekanik gjatë periudhës 01.02.1995 – 31.10.2001, me pagë mujore 45.000 lekë. Sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Elbasan, për vitet 1995, 1996, 1997 dhe periudhën gusht – dhjetor 1998 nuk ka listëpagesa (bordero), ndërsa për periudhat janar – korrik 1998, 1999, 2000 dhe 2001, emri i shtetasit A. M. nuk figuron në listëpagesë.
75. Komisioni, nga verifikimi në faqen *online* të Qendrës Kombëtare të Biznesit, të ekstraktit historik të shoqërisë “{***}” ShPK, ka konstatuar se kjo shoqëri është themeluar në datën 22.10.1995 dhe është regjistruar në datën 13.3.1996, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit pretendon të ardhura nga

punësimi pranë saj, duke filluar që nga data 01.02.1995, pra 13 muaj përpara regjistrimit të shoqërisë sipas detyrimit ligjor.

76. Në analizë të akteve sa më sipër, si dhe të pretendimeve të subjektit, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë, Komisioni nuk i ka përlllogaritur këto të ardhura në analizën financiare, në kushtet kur për to nuk u konstatua asnjë dokumentacion justifikues që të provonte krijimin dhe vlerën e tyre. Nga aktet në fashikuj, rezultojnë të dhëna për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore vetëm për punësimin e babait të subjektit të rivlerësimit në disa ndërmarrje shtetërore, për periudhën 1994-2000, sipas shkresës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSh) Elbasan¹⁴. Marrëdhënia e punësimit të babait të subjektit pranë shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, nuk provohet me akte nga organet tatimore apo ato të ISSh-së¹⁵ dhe, në këto kushte, vetëm vërtetimi i sjellë nga shoqëria, nuk mund të ketë vlerën e provës në lidhje me të ardhurat e pretenduara. Edhe në eventualitetin që do të provohej krijimi i tyre, ato nuk do të mund të vlerësohen të ardhura të ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit, duke u përfshirë në analizën financiare, për sa kohë nuk plotësojnë standardin e të ardhurave të ligjshme sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk arrin as të provojë që për to janë paguar detyrimet tatimore përkatëse.
77. Trupi gjykues çmon se rezulton i pabazuar edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në të ardhurat e prindërve kanë pasur ndikim edhe kontributet e fëmijëve, pasi vetëm nga balancat pozitive të vërtetuara nga analiza financiare e Komisionit për vitet 2005 – 2006, në kushtet e mosdeklarimit të gjendjes *cash*, por edhe analiza financiare e paraqitur nga ana e tij, rezulton e mundur ndihma financiare për prindërit. Konstatohet se ky është një pretendim që subjekti i rivlerësimit e ka ngritur vetëm pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, pasi është njohur me analizën financiare të rezultateve të hetimit, dhe mbetet në nivel deklarativ për sa kohë që nuk është deklaruar nga subjekti si në deklaratën *vetting*, ashtu dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorëve, si dhe nuk ka përcaktuar një vlerë e nuk ka sjellë asnjë akt për ta provuar këtë pretendim.
78. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se për këtë apartament, Komisioni në mënyrë të gabuar dhe të kundërligjshme i ka kaluar barrën e provës për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të babait, ndërkohë që babai i tij, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka qenë as në cilësinë e dhuruesit dhe as në atë të huadhënësit, trupi gjykues vëren se Komisioni, në kushtet e ekzistencës së një marrëdhënieje përdorimi, e cila mund të passjellë dyshime për fshehje, ka kryer një hetim të plotë për provueshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie e për lidhje të mundshme të subjektit me të. Kolegji ka vlerësuar në jurisprudencën¹⁶ e tij se Komisioni, lidhur me pasuritë në përdorim të subjekteve të rivlerësimit, ka detyrimin të analizojë dhe evidentojë saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me to, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane që mund të ngrejë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të tij, që mund të rezultojnë të jenë krijuar

¹⁴ Sjellë nga subjekti bashkëlidhur deklaratës “vetting”.

¹⁵ Sipas shkresës së Drejtorisë së Arkivit Qendror nr. {***} prot., datë 08.08.2023, nuk ka të dhëna për subjektin “{***}” ShPK, për periudhën 1995-2001.

¹⁶ Shih vendimet e Kolegjit nr. 10/2022 (JR); nr. 3/2023 (JR).

nga vetë subjekti i rivlerësimit. Edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se ai nuk ka pasur detyrim ligjor në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të apartamentit të përdorur prej tij, pasi babai i subjektit nuk plotëson kërkesat e këtyre dispozitave ligjore për t'u konsideruar person tjetër i lidhur, në kushtet e një marrëdhënieje përdorimi të vazhdueshme e shumëvjeçare, nuk mund të përjashtohet nga Komisioni verifikimi i të gjitha burimeve të deklaruara nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie.

79. Në përfundim të sa analizuar më sipër lidhur me burimet e krijimit të apartamentit, trupi gjykues çmon se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se personi i lidhur/nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën prej 1.482.311 lekësh për pagesën e këstit të parë në datën 11.12.2006, për blerjen e apartamentit në Elbasan.
80. Subjekti kundërshton kualifikimin nga Komisioni të apartamentit si një pasuri e fshehur e tij, duke argumentuar se ai e ka deklaruar si vendbanim, si dhe ka deklaruar marrjen e kredisë për apartamentin në deklaratën *vetting*. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues vëren se, pavarësisht nga sa parashtron subjekti i rivlerësimit, ai nuk arrin të argumentojë në mënyrë bindëse domosdoshmërinë e marrjes së një kredie në emër të tij, për të ndihmuar prindërit, të cilët e kishin një apartament banimi, ndërkohë që ai vetë jetonte në të njëjtin qytet dhe nuk kishte një banesë të tijën. Një rrethanë që rrëzon pretendimet e subjektit të rivlerësimit është edhe fakti që vetëm ai dhe familja e tij kanë banuar në këtë apartament që në vitin 2008, siç ka deklaruar dhe vetë, ndërkohë që rezulton e provuar se prindërit, për të cilët supozohej se ishte porositur apartamenti, vazhdonin të jetonin në apartamentin e vjetër, duke mos e gëzuar pronën e re, ndërsa nëna është transferuar në apartamentin e ri vetëm në vitin 2014, pas vdekjes së babait të subjektit. Gjithashtu, trupi gjykues, nga aktet e administruara nga Komisioni, konstaton se dhe kontrata me shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime, Elbasan, sipas kërkesës së investitorit është regjistruar në vitin 2009, në emër të subjektit të rivlerësimit, dhe jo në emër të babait të tij, i cili ishte porositësi i apartamentit sipas kontratës së porosisë të datës 11.12.2006.
81. Për sa parashtruar më sipër, në kushtet kur: (i) subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* nuk ka bërë deklarime të plota rreth marrëdhënies me këtë pasuri; (ii) nëna e subjektit të rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit; (iii) edhe pse subjekti nuk rezulton të ketë të drejta pronësie mbi këtë apartament, ai ka kontribuar në një shumë të konsiderueshme prej 2.500.000 lekësh për blerjen, nëpërmjet marrjes së kredisë në emër të tij; (iv) nga aktet në dosjen e Komisionit rezultoi e provuar se emri i subjektit figuron në listën emërore të banorëve të paraqitur si aplikantë nga investitori pranë shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime, Elbasan, dhe që kontrata e furnizimit me ujë nuk është lidhur në emër të prindërve, por në emrin e tij; (v) nga viti 2008 e në vazhdim, pa ndërprerje, subjekti ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme përdorimi të apartamentit, që nga momenti i ndërtimit të tij; (vi) vetëm pas vdekjes së babait të subjektit, në prill të vitit 2014, nëna e tij është transferuar në apartamentin ku banon subjekti; krijohen dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit ka fshehur rrethanat me qëllim përjashtimin nga kontrolli të kësaj pasurie, dhe se apartamenti në fjalë është një pasuri e fshehur e tij.

82. Në përfundim, në vlerësim të trupit gjykues, deklarimi i subjektit të rivlerësimit se ka vetëm të drejta banimi dhe deklarimi i personit të lidhur në deklaratën *vetting* i të drejtës së pronësisë për apartamentin nuk krijojnë bindje për vërtetësinë e tyre. Trupi gjykues vlerëson të bazuar konkluzionin e Komisionit se personi i lidhur/nëna e subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën prej 1.482.311 lekësh për pagesën e kështit të parë në datën 11.12.2006 për apartamentin në Elbasan. Për rrjedhojë, në konsideratë edhe të konkluzioneve të mësipërme, për pasurinë në përdorim, apartament me sipërfaqe 112 m², në Elbasan, të deklaruar në deklaratën *vetting* në pronësi të nënës, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me dyshimet për pronësinë e këtij apartamenti, duke paraqitur rrethana jo të vërteta që krijojnë bindjen për fshehje të kësaj pasurie, dhe gjendet në kushtet e shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
83. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit për kriterin e kontrollit të figurës

84. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “ç” të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me kontrollin e figurës në formularin sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, duke fshehur kontaktin me shtetasin Th. B., si person i përfshirë në krimin e organizuar, referuar pikës 4 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e pikave 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
85. Subjekti i rivlerësimit parashtroi në ankimin drejtuar Kolegjit se nuk ka deklaruar kontaktin me shtetasin Th. B. pasi, në dijeninë e tij, ky shtetas nuk ka qenë ndonjëherë i hetuar dhe gjykuar për ndonjë vepër penale. Subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka pasur kontakte personale me këtë shtetas, por vetëm kontakte rastësore për shkak të lidhjeve familjare e shoqërore. Për këto arsye, ai nuk ka pasur dijeni për procedimin penal në ngarkim të shtetasit Th. B., të regjistruar në muajin janar të vitit 2009, në ish-Gjykatën e Krimeve të Rënda, Tiranë, as nga ai vetë dhe as nga persona të tjerë të njohur. Sipas subjektit të rivlerësimit, në nenin 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, jepet përkufizimi i “personit të përfshirë në krimin e organizuar”, dhe nga interpretimi i kësaj dispozite, nuk rezulton që shtetasi Th. B. të jetë i përfshirë në krimin e organizuar, pasi procedimi penal ndaj të tij është pushuar në përfundim të hetimeve, në bazë të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas subjektit, në rastet e pushimit të çështjes penale nga organi i akuzës, personat konsiderohen të përfshirë në krimin e organizuar vetëm kur *procedimi penal ka filluar dhe është pushuar për shkak të vdekjes ose rastet kur personi nuk mund të merret si i pandehur*.
86. Trupi gjykues vëren nga aktet se DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së këtij subjekti. Menjëherë pas shortimit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, me shkresën nr. {***}, datë 08.06.2023, i ka kërkuar

Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”¹⁷) rifreskim dhe përditësim informacioni. AKSIK-u ka përcjellë në Komision, me shkresën nr. {***}, datë 05.10.2023, raportin e deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 05.10.2023, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit, sipas të cilit ka vlerësuar papërshtatshmërinë për vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi. Grupi i punës pranë AKSIK-ut ka raportuar: *se nga informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në rastin tonë të një prokurori, në periudha të shkëputura kohe e në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, sipas kërkesave të shkronjave “b” e “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale, duke ndryshuar kështu konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.*

87. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, pas denoncimit të shtetasit A. H. se subjekti i rivlerësimit shoqërohej me shtetasin Th. B., person i njohur në Elbasan për shkak të së shkuarës kriminale, në pyetësonin nr. 3 i ka kërkuar subjektit të deklaronte nëse ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nëse njihej me shtetasin në fjalë.
88. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësonit nr. 3, ka deklaruar se: *Shtetasin Th. B. e njoh prej shumë vitesh, që në kohën që jam njohur me bashkëjetuesen I. B., në vitin 1999, pasi ai dhe familja e tij kanë lidhje miqësore dhe familjare me familjen e S. B., babait të bashkëjetueses. Ndërkohë që shtetasi V. Gj., bashkëshorti i shtetas A. Gj. (B.), motrës së bashkëjetueses sime, është kushëri i parë me shtetasin Th. B., pasi e ka djalin e hallës. Gjithashtu, me shtetasen A. Gj. (B.), që përpara se unë të njihja bashkëshorten time, kam pasur lidhje shoqërore të mëparshme, pasi kemi pasur shoqëri që në kohën që studionim në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, në vitet 1991 – 1995. Gjithashtu, bashkëshortja e shtetasit Th. B., shtetasja E. U., është lidhje e jona shoqërore, pasi me shtetasen A. Gj. (B.) kanë qenë bashkë në shkollën e mesme në Elbasan. Për shkak të këtyre lidhjeve, jam njohur edhe unë me shtetasin Th. B. dhe marrëdhëniet e mia me të kanë qenë vetëm në kuadër të këtyre lidhjeve familjare dhe shoqërore. Në punën time të përditshme, unë nuk kam pasur ndonjë situatë konflikti interesi në lidhje me këtë shtetas, ashtu si edhe në jetën e përditshme as unë dhe as familjarët e mi nuk kemi pasur me të ndonjë lidhje interesash ekonomike.*
89. Pas kërkesës së Komisionit, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka informuar¹⁸ se ndaj shtetasit Th. B. etj., në datën 01.01.2009, është regjistruar procedimi penal nr. {***}, në ish-Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal. Pas kryerjes së hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, është vendosur pushimi i hetimeve në lidhje me shtetasin Th. B., në datën 10.10.2009, dhe pezullimi i procedimit penal nr. {***}, viti 2009.

¹⁷ Ka ndryshuar emërtimi nga DSIK në AKSIK, sipas ligjit nr.10/2023.

¹⁸ Me shkresën nr. {***}, datë 26.10.2023,

90. Nga aktet, rezulton se procedimi penal nr. {***}, ndaj shtetasit Th. B., është regjistruar për veprën penale “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal. Referuar pikës 15¹⁹ të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku jepet përkufizimi për individët e përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të këtij ligji, sipas të cilit është i përfshirë në krimin e organizuar çdo person që është dënues ose proceduar penalisht për veprat e parashikuara në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, trupi gjykues vëren se vepra për të cilën është proceduar shtetasi Th. B., bën pjesë në rrethin e veprave të parashikuara nga ky ligj.
91. Kolegji, në vendimin nr. 10/2019, është shprehur se: [...] Sipas parashikimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se, që një person të konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar”, në kuptim të këtij ligji: a) Duhet të jetë i proceduar penalisht për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009. Në kuptim të dispozitave procedurale penale, statusin e personit të proceduar penalisht e merr ai shtetas të cilit i regjistrohet emri në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, ku prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet, duke shënuar edhe emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale; b) Personi i cili është proceduar për veprën si më lart, nuk duhet të jetë deklaruar i pafajshëm me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Po në këtë vendim, Kolegji ka mbajtur qëndrimin se: [...] pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, është një dispozitë mjaft shtrënguese, që në “personat e përfshirë në krimin e organizuar” filtron edhe individët për të cilët procedimi penal ka filluar dhe është pushuar për shkak të vdekjes ose rastet kur personi nuk mund të merret si i pandehur, si dhe personat të cilët janë deklaruar të pafajshëm për shkak se vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose dënohet, duke përjashtuar rastin e vetëm të përfshirjes në krimin e organizuar, kur personi është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret, për subjektin e rivlerësimit është vendosur pushimi i procedimit penal, në ngarkim të tij. Në këto rrethana, duke qenë se pushimi i procedimit penal nuk parashikohet si rast përjashtimor nga neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, si pasojë duhej të deklarohet nga subjekti i rivlerësimit [...].
92. Nga interpretimi i mësipërm i Kolegjit, si dhe në analizë të të dhënave nga aktet e administruara në Komision, rezulton se shtetasi Th. B. ka qenë i proceduar penalisht për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, dhe pavarësisht se është vendosur pushimi i hetimeve në lidhje me këtë shtetas, për sa kohë nuk ka pasur një vendim pafajësie, sipas parashikimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ai konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”. Për rrjedhojë, bazuar dhe

¹⁹ “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënues ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet.

në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për një njohje miqësore dhe familjare, prej shumë vitesh, me këtë shtetas, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në referim të shkronjës “ç” të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

93. Për sa i përket konkluzionit tjetër të Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm lidhur me kontrollin e figurës në formularin sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, duke fshehur kontaktin me shtetasin Th. B. si person i përfshirë në krimin e organizuar, trupi gjykues vëren se nga aktet që disponohen nga hetimi administrativ në Komision, nuk është arritur që të provohet dijenia e subjektit për procedimin penal të regjistruar në ngarkim të këtij shtetasi në janar të vitit 2009. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se nuk mund të konkludohet për deklaratim të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit, referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
94. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sepse pavarësisht se nuk provohet dijenia e tij për procedimin penal ndaj shtetasit Th. B., pikërisht pasja e kontaktit të papërshtatshëm, si pasojë e një marrëdhënieje shoqërore afatgjatë me këtë shtetas të përfshirë në krimin e organizuar, prezumon vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Në vijim të arsyetimit të kësaj situatë faktike, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit, për shkak të kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me nenin Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, çka e bën të pamundur vazhdimin e detyrës.
95. Trupi gjykues vëren se lidhur me kriterin e figurës, Komisioni ka marrë në shqyrtim procedimet penale nr. {***}, dhe nr. {***}, për të cilat në përfundim ka konkluduar se krijohen dyshime të arsyeshme se subjekti ka favorizuar të dyshuarin/personin nën hetim, rrethana që janë vlerësuar bashkë me komponentët e tjerë të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale.
96. Për sa i përket procedimit penal nr. {***}, nga aktet e administruara në Komision, rezulton se në datën 22.08.2020, në segmentin rrugor Elbasan-Peqin, në vendin e quajtur {***}, ka ndodhur një aksident rrugor mes tri automjeteve. Ka rezultuar se automjeti “Renault”, me drejtues shtetasin Gj. H., po qarkullonte nga vendi i quajtur “{***}” për t’u futur majtas, te fabrika e Lëkurëve dhe në këtë kohë është përplasur në pjesën e pasme nga mjeti furgon, që drejtohej nga shtetasi A. Gj.. Ky i fundit, pas përplasjes me mjetin “Renault”, ka përplasur dhe automjetin “Volkswagen” të shtetasit G. M., që ka qenë i pozicionuar jashtë rruge. Nga ky aksident, ka mbetur i dëmtuar babai i shtetasit G. M., Q. M., i cili ka qenë duke u futur në mjetin e djalit të tij. Pasi është transportuar në spitalin rajonal, ka rezultuar jashtë rrezikut për jetën. Nga testi i alkoolit, ka rezultuar se shtetasi A. Gj. nuk ka konsumuar pije alkoolike.
97. Sipas aktit të ekspertimit auto-teknik të datës 24.8.2020, shkak determinant për ndodhjen e aksidentit, kanë qenë shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e shtetasit A. Gj., pasi nuk ka ruajtur kontrollin e drejtimit të mjetit dhe nuk ka frenuar në mënyrë të menjëhershme sipas parashikimit të nenit 139 të Kodit Rrugor, si dhe nuk ka ruajtur distancën e sigurisë ndaj mjetit në lëvizje përpara tij, duke mos zbatuar detyrimet e nenit 147 të Kodit Rrugor. Nuk rezulton të jetë kryer akti i ekspertimit mjekoligjor, pasi i dëmtuari nuk i është nënshtruar ekzaminimit mjekoligjor.

98. Subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, me vendimin e datës 9.9.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se nga aksidenti nuk kanë ardhur pasojat e parashikuara nga neni 290 i Kodit Penal (plagosja e lehtë e disa personave, plagosja e rëndë e një personi, vdekja e një personi, vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave).
99. Kundër vendimit të subjektit, ka paraqitur ankim në gjykatë i dëmtuari Q. M.. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 24.1.2022, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe regjistrimin e procedimit penal për veprën penale "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal. Në vendimin e saj, gjykata arsyeton se: *Për t'u konsideruar e kryer kjo figurë penale, kërkohen të plotësohen nga ana objektive këto elemente: shkelja e dispozitës konkrete të përcaktuar në Kodin Rrugor; ardhja e pasojës konkrete të kërkuar nga dispozita penale [...] si dhe lidhja shkakësore mes veprimit dhe pasojës konkrete të ardhur. Në rastin objekt hetimi, këto elemente nuk rezultojnë të hetuar nga organi procedues. Së pari, kemi përcaktimin e faktit nëse kemi shkelje të rregullave të përcaktuara në Kodin Rrugor, nga kush janë shkelur këto rregulla dhe shkakun determinat i ndodhjes së aksidentit. Së dyti, nuk është bërë e mundur të kryhet akti i ekspertimit mjekoligjor, pasi i dëmtuari nuk i është nënshtruar ekspertimit mjekoligjor. Në vijim, gjykata arsyeton se organi procedues nuk ka thirrur dhe pyetur të dëmtuarin në lidhje me rrethanat e faktit apo me dëmtimet e pësura dhe se i dëmtuari bashkë me ankimin, ka depozituar akte shkruese, sipas të cilave është shtruar në Spitalin Ushtarak Tiranë më datë 22.8.2020, pas një traume në aksident automobilistik, dhe ky konstatim çon gjykatën në konkluzionin se duhet të kryhet akti i ekspertimit mjekoligjor për të përcaktuar dëmtimet dhe kategorizimin e tyre, ku të kryhet mbi bazë të kartelës së SUT Tiranë dhe ekzaminimit të të dëmtuarit. Gjithashtu, gjykata arsyeton se gjatë hetimit, duhet të përcaktohet dhe lidhja shkak-pasojë.*
100. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) subjekti nuk i ka njoftuar të dëmtuarit vendimin e datës 9.9.2020, për mosfillimin e procedimit penal, sipas parashikimit të nenit 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale; (ii) subjekti ka marrë vendimin e datës 9.9.2020 për mosfillimin e procedimit penal, pa kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk ka administruar aktin e ekspertimit mjekoligjor, me qëllim vërtetimin e pasojave të parashikuara nga neni 290 i Kodit Penal; (iii) veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti janë kryer të shkëputura në kohë, pasi akti i ekspertimit mjekoligjor është hartuar dhe dorëzuar në organin procedues pas më shumë se 1 viti nga data e marrjes së vendimit për kryerjen e tij, ndodhjes së aksidentit dhe shtrimit në spital të të dëmtuarit; (iv) subjekti nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, pasi: (a) ka regjistruar procedimin penal pas më shumë se 3 muajve nga paraqitja e vendimit të gjykatës në organin procedues; (b) ka regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale pas më shumë se 9 muajve nga regjistrimi i procedimit penal, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer ndonjë veprim hetimor për zbulimin e autorit të veprës penale dhe vërtetimin e pasojave nga aksidenti; (c) ka zgjatur për një periudhë prej 1 viti e 5 muajsh afatet e përfundimit të hetimeve, pa shkaqe të arsyeshme; (v) subjekti, me marrjen e vendimit të datës 9.9.2020, për mosfillimin e procedimit penal, me tejzgjatjen e afateve të përfundimit të hetimeve pa shkaqe të arsyeshme, pasi çështja është kthyer nga gjykata, ka favorizuar të pandehurin.
101. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, në lidhje me mosnjoftimin e vendimit të mosfillimit, sqaron se në pikën 4 të vendimit, është vendosur që vendimi t'i njoftohet të dëmtuarit dhe

palëve të interesuara nëpërmjet sekretarisë së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe ka qenë detyrim që njoftimi të bëhej nga sekretaria.

102. Për sa i përket konstatimit se vendimi i mosfillimit të procedimit penal, është marrë pa administruar aktin e ekspertimit mjekoligjor, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në Komision se eksperti mjekoligjor ka parashtruar se i dëmtuari nuk ishte paraqitur në Spitalin Rajonal Elbasan dhe nuk kishte kartelë spitalore. Subjekti ka sqaruar se i ka kërkuar ekspertit që ky komunikim t'i referohej me shkresë zyrtare, gjë e cila nuk u realizua nga ana e ekspertit. Më pas, subjekti ka shpjeguar se duke pasur në konsideratë që vendimi i mosfillimit të procedimit penal është i cenueshëm nga gjykata nëpërmjet ankimit të të dëmtuarit nga momenti i marrjes dijeni të vendimit, për të mos cenuar edhe afatin 15-ditor të parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për mungesë të aktit mjekoligjor, duke orientuar të dëmtuarin për ankimin e vendimit të mosfillimit të procedimit në gjykatë.
103. Lidhur me konstatimin e Komisionit se ka regjistruar procedimin penal me vonesë, nga momenti i ardhjes së vendimit të gjykatës në organin e akuzës, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kjo vonesë ka ardhur për shkak të ngarkesës mbi normalen si në gjykim, edhe në hetimin e procedimeve penale, si dhe për shkak të mbingarkesës së sekretarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Megjithatë, sipas subjektit, edhe pse regjistrimi i procedimit penal është kryer me vonesë, kjo rrethanë nuk përbën shkak për pavlefshmëri apo papërdorshmëri të akteve hetimore procedurale dhe nuk ka sjellë pasojë në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
104. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në datën 25.04.2023, janë përfunduar hetimet në lidhje me këtë çështje penale dhe i është drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim me të pandehur A. Gj., akuzuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal dhe aktualisht kjo çështje është në gjykim.
105. Nga verifikimi i akteve të dosjes penale të administruar nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal në datën 09.09.2020. Sipas vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 24.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i dëmtuari është vënë në dijeni të vendimit të prokurorit në datën 07.09.2021, në rrethana të tjera, dhe ka paraqitur ankim në gjykatë në datën 17.09.2021. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në Komision ndonjë provë për të vërtetuar datën e dorëzimit të vendimit të mosfillimit në sekretari, si dhe të njoftimit të palës së dëmtuar. Për pasojë, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, duke mos njoftuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal, nuk ka plotësuar detyrimin e parashikuar në nenin 291, pika 2²⁰ e Kodit të Procedurës Penale.
106. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal bazuar vetëm në aktin e ekspertimit autoteknik, por pa administruar aktin e ekspertimit mjekoligjor, i cili shërben për vërtetimin e pasojave, si një nga elementet e domosdoshme të anës objektive të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Nga aktet, konstatohet se vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit mjekoligjor është marrë në datën 22.08.2020, ndërsa akti

²⁰ “2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.”

i ekspertimit mjekoligjor nr. {***}, datë 07.09.2021, “Mbi shqyrtimin e kartelës ditore të shtetasit Q. M.”, në të cilin konkludohet se dëmtimet që i janë shkaktuar të dëmtuarit hyjnë në kategorinë e atyre që kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit, është protokolluar në organin procedues në datën 9.9.2021, pas më shumë se 1 viti nga data e marrjes së vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit, ndodhjes së aksidentit dhe shtrimit në spital të të dëmtuarit. Për pasojë, rezulton se veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit janë kryer të shkëputura në kohë, pasi akti i ekspertimit mjekoligjor është hartuar dhe dorëzuar në organin procedues pas më shumë se 1 viti nga data e ndodhjes së aksidentit, shtrimit në spital të të dëmtuarit dhe marrjes së vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit.

107. Nga shqyrtimi i akteve dhe veprimeve hetimore të kryera në vazhdim, rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. {***}, datë 24.1.2022, për regjistrimin e procedimit penal, është protokolluar në Prokurorinë e Rrethit Elbasan në datën 22.2.2022. Subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal në datën 10.6.2022, pa emër personi dhe regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale, është bërë në datën 17.04.2023, pra pas 10 muajve e 7 ditëve nga administrimi i aktit të ekspertimit mjekoligjor, në datën 09.09.2021. Subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës në datën 25.04.2023, dhe në datën 18.07.2023 i është drejtuar gjykatës me kërkesën për gjykimin e çështjes.
108. Referuar të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se, ashtu si dhe është konstatuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, duke i zvarritur dukshëm ato, pasi ka regjistruar procedimin penal pas më shumë se 3 muajve nga paraqitja e vendimit të gjykatës në organin procedues, ka regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale pas më shumë se 10 muajve nga regjistrimi i procedimit penal, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer ndonjë veprim hetimor, si dhe ka zgjatur për një periudhë prej rreth 1 viti e 5 muajsh afatet e përfundimit të hetimeve pa shkaqe të përligjura, veprime të cilat demonstrojnë mungesë të angazhimit e përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksioneve.
109. Si konkluzion, duke marrë në konsideratë se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal pa kryer veprimet e nevojshme hetimore, ka kryer veprimet hetimore të shkëputura në kohë, pas kthimit të çështjes nga gjykata nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore duke i zvarritur ato, si dhe në shpjegimet e dhëna në Komision, pranon që në rastin konkret nuk plotësoheshin kushtet e parashikuara për marrjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, është i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin: (i) e njohurive ligjore bazuar në aftësitë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) e kriterit të aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësisë për të administruar dosjet gjyqësore, sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) e kriterit të etikës së magjistratit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
110. Në kushtet kur vlerësimi i çështjes penale ka ardhur si pasojë e informacioneve mbi integritetin e figurës së subjektit të rivlerësimit, të ngritura nga organet ligjzbatuese, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin, i cili ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar në mënyrë të hapur personin e

dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, rrethanë e cila është vlerësuar bashkë me komponentët e tjerë të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale që afektojnë cenimin e besimit të publikut të drejtësia.

Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit mbi vlerësimin e aftësive profesionale

111. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, shprehur se konkluzionet e Komisionit nuk janë të bazuara dhe të provuara, por thjesht të supozuara, aq më tepër kur konkludojnë për shkelje që kanë cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni nuk janë konstatuar shkelje të rënda, si mund të jenë kualifikimi jo i drejtë i një veprë penale apo pushimi i akuzës në një kohë që është provuar vepra, dhe të gjitha konstatimet janë në kuadrin e dyshimeve, të prezumuara si të mirëqena. Në përfundim, për këtë kriter, subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë kohës së ushtrimit të detyrës, ka treguar integritet profesional dhe nuk është në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë.
112. Në shqyrtim të shkaqeve të ankimit për këtë kriter, së pari trupi gjykues vëren se në ankim, subjekti nuk ka bërë prapësime konkrete ndaj konkluzioneve të Komisionit, por u referohet prapësimeve që ka bërë gjatë procesit të zhvilluar në Komision. Për këtë arsye, në analizë të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, si dhe të shkaqeve të ankimit ndaj këtij vendimi, referimi do të bëhet në aktet/prapësimet e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të rezultateve të hetimit, pasi edhe në seancën dëgjimore në Komision, subjekti u është referuar po këtyre prapësimeve, duke u shprehur se i ka paraqitur me shkrim.
- Analiza e çështjeve të trajtuara në vendim në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, do të kryhet sipas strukturës së përcaktuar në vendimin e Komisionit dhe që i referohet grupit të dokumenteve ligjore të depozituara prej subjektit, grupit të çështjeve të përzgjedhura për kontroll sipas një shorti rastësor, si dhe grupit të çështjeve për të cilat hetimi i Komisionit ka nisur mbi bazën e denoncimeve të publikut të paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit.
113. Nga dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, sipas parashikimit të nenit 3, pika 2²¹ e ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rezultatet e hetimit ka marrë në shqyrtim dokumentin nr. {***}, “Konkluzione përfundimtare”, që i përket procedimit penal nr. {***} të vitit 2014. Për këtë procedim, KLP-ja, në raportin e analizimit të aftësive profesionale, ka vlerësuar se: [...] *vendimmarrja për pushimin e hetimeve të shtetasit L. T. nuk është objektive. Argumenti se sasia e lëndës së sekuestruar është për përdorim vetjak, nuk është argument i saktë dhe në përputhje me rrethanat e çështjes. Pavarësisht se ky shtetas është përdorues i lëndës narkotike, gjetja dhe sekuestrimi njëkohësisht i sasisë së heroinës, kanabisit dhe farave të kanabisit të ky shtetas, nga ana objektive, provojnë konsumimin nga ana e tij të elementeve të veprës penale “Mbajtje e lëndës narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.*

²¹ “Dokument ligjor” është çdo dokument i përgatitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës profesionale, në veçanti vendim, raport/relacion, kërkesë për gjykim penal, mendim/opinion ligjor, si dhe akte të tjera që provojnë aftësitë profesionale të tij.

114. Lidhur me pushimin e çështjes ndaj shtetasit L. T., referuar rrethanave faktike të pasqyruara në dokumentin "Konkluzione përfundimtare", Komisioni ka konstatuar se për këtë shtetas, procedimi penal ka filluar pasi dyshohej se kryente aktivitetin e shitjes së lëndëve narkotike. Nga kontrolli fizik, të dyshuarit i janë sekuestruar 6 porcione lëndë narkotike heroinë, 3,05 gramë lëndë narkotike *cannabis sativa* dhe, nga kontrolli i banesës, 31 fara kanabis. Komisioni ka konstatuar se vendimi për pushimin e hetimeve ndaj personit nën hetim L. T., për veprën penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve", e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, është i paqartë, pasi duket se konkluzioni për pushimin e hetimeve nuk bazohet në situatën faktike, por është mbështetur vetëm në konkluzionet e aktit të ekspertimit toksikologjik, dhe për këtë konstatim i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit.
115. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nga informacionet policore të përcjella verbalisht, arriti në përfundimin se kontrolli dhe arrestimi i shtetasit L. T. ishin masa të përshtatshme, me qëllim dhënien e deklarimeve lidhur me përgjegjësinë penale të personave organizatorë të shpërndarjes së lëndëve narkotike në qytetin e Gramshit. Strategjia hetimore rezultoi e drejtë, pasi shtetasi i mësipërm dha indicie dhe të dhëna në lidhje me organizatorët e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se nga hetimi, ka rezultuar se shtetasi L. T. nuk ka qenë shitës i lëndëve narkotike, por thjesht përdorues i tyre, bazuar dhe në aktin e ekspertimit toksikologjik nr. {***}, datë 14.07.2014, dhe ekspertimit kimik nr. {***}, datë 17.11.2014, nga i cili rezultoi se farat e sekuestruara janë të ngjashme me ato të *cannabis sativa*, por nuk mund të përcaktohen se çfarë janë dhe nuk përmbajnë elementë THC të lëndës narkotike.
116. Para zhvillimit të seancës dëgjimore në Komision, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si prova: vendimin nr. {***}, datë 13.06.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të cilin është vendosur: *deklarimi fajtor i të pandehurit L. B. për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe shitje e narkotikëve" dhe në bazë të nenit 283, paragrafi i parë, dhe nenit 47 të Kodit Penal, dënimi i tij me 5 vjet burgim*; vendimin nr. {***}, datë 16.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të cilin është vendosur: *deklarimi fajtor i të pandehurit D. B. për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", e kryer në bashkëpunim, dhe në bazë të nenit 283, paragrafi i dytë, nenit 48 "ç" dhe nenit 47 të Kodit Penal, dënimi i tij me 7 vjet e gjashtë muaj burgim*; vendimin për kryerjen e ekspertimit toksikologjik-klinicist për personin nën hetim L. T. , të datës 20.11.2024; akt ekspertimit adiktologjik-toksikologjik klinik për shtetasin L. T. , nr. {***}, datë 05.12.2014; vendimin për pushimin e pjesshëm të hetimeve për procedimin penal nr. {***}, të datës 06.01.2015, me të cilin është vendosur pushimi i hetimeve ndaj personit nën hetim L. T. .
117. Në vijim të analizës së KLP-së, Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë²², ka arsyetuar se, për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lëndës narkotike të nevojshme për përdorim vetjak, duhen thirrur në çdo rast specialistë të fushës, por, për zgjidhjen përfundimisht të çështjes, është i nevojshëm edhe sqarimi i rrethanave faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës narkotike apo psikotrope nga personi i dyshuar.
118. Komisioni ka konstatuar se në dokumentin "Konkluzione përfundimtare", subjekti i rivlerësimit, në marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal ndaj shtetasit L. T. , është mbështetur vetëm

²² Vendimin unifikues nr. 1, datë 27.3.2008.

në konkluzionet e aktit të ekspertimit toksikologjik, që ka përcaktuar se sasia e sekuestruar konsiderohet dozë e vogël, duke mos vlerësuar rrethanat e tjera faktike, sikurse janë posedimi i llojeve të ndryshme të lëndëve narkotike dhe dyshimeve se kryente aktivitet në shitjen e lëndës narkotike. Për pasojë, Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në interpretimin e ligjit dhe analizimin e jurisprudencës.

119. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesit e aftësisë për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
120. Në shqyrtim të konstatimeve dhe konkluzioneve të mësipërme nga Komisioni, si dhe të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj rezultateve hetimore, nga aktet konstatohet se me vendimin e datës 20.11.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur kryerjen e ekspertimit toksikologjik-klinicist, duke thirrur ekspert toksikolog të Shërbimit të Toksikologjisë pranë Qendrës Spitalore “Nënë Tereza”, i cili duhej t’i përgjigjej pyetjes: *Duke u nisur nga lloji i lëndës narkotike të sekuestruar, sasisë së saj, cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së varësisë nga droga të personit nën hetim L. T. , vetë sasia e bimës narkotike të sekuestruar, a është dozë e madhe apo e vogël për përdorim vetjak nga ky person?* Nga akti i ekspertimit adiktologjik-toksikologjik klinik nr. {***}, datë 05.12.2014, për shtetasin L. T. , rezulton se eksperti ka konkluduar se: *sasia prej 2,401 gramësh “cannabis sativa”, me përqendrim mesatar 9,92% THC dhe sasia prej 0,524 gramësh heroinë, me përqendrim të principit aktiv 9,27% është për përdorim vetjak, brenda tolerancës së organizmit të shtetasit L. T. , pa shkaktuar dëmtime serioze të shëndetit të tij.*
121. Me vendimin e datës 06.01.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve ndaj personit nën hetim L. T. , për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, pasi nuk provohet që sasinë e lëndës narkotike, shtetasi L. T. ta ketë mbajtur për qëllim shitjeje apo për çdo qëllim tjetër dhe, sipas aktit të ekspertimit adiktologjik-toksikologjik, kjo sasi konsiderohet dozë e vogël për përdorim vetjak. Subjekti në këtë vendim ka arritur në përfundimin se personi në hetim L. T. nuk ka konsumuar elementet e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, meqenëse jemi para kushtit përjashtimor të anës objektive të veprës penale, kusht i cili parashikon që fakti nuk përbën vepër penale në rast se “sasia e lëndës narkotike është e vogël dhe për përdorim vetjak”.
122. Nga përmbajtja e vendimit për pushimin e hetimeve, trupi gjykues konstaton se subjekti ka vendosur pushimin e hetimeve ndaj personit në hetim L. T. , bazuar vetëm në aktin e ekspertimit toksikologjik-klinicist, nga ku ka rezultuar lënda narkotike në formën pluhur dhe bimë/*cannabis sativa* është për përdorim vetjak, brenda tolerancës së organizmit të shtetasit L. T. , pa shkaktuar dëmtime serioze të shëndetit të tij. Por vihet re se në këtë konkluzion të ekspertit toksikolog, subjekti i rivlerësimit ka shtuar dhe fjalët “*edhe në marrje të vetme*”, të cilat nuk figurojnë të jenë përmendur në aktin e ekspertit. Gjithashtu, në vendim subjekti nuk është shprehur për sasinë tjetër të lëndës narkotike të gjendur në banesë, farat e bimës *cannabis sativa*, me peshë pa ambalazh 0,480 gramë. Në vendim citohet se farat nuk iu nënshtruan ekzaminimeve, pasi me analizat kimike nuk mund të përcaktohet varieteti i tyre dhe, nga literatura, farat e bimës *cannabis sativa* nuk përmbajnë THC. Për këtë arsye, nga sa paraqitet në vendim, rezulton se për farat bimore, nuk ka pasur një konkluzion se kanë qenë për përdorim vetjak,

për më tepër që dhe nga natyra/forma e papërpunuar e tyre, ato nuk mund të jenë për konsum. Në vlerësimin e shkaqeve për pushimin e hetimit ndaj shtetasi L. T. , subjekti e ka anashkaluar këtë fakt. Sa më sipër në këtë vendim, rezulton se subjekti nuk ka vlerësuar gjithë rrethanat faktike, si dhe ka bërë një interpretim të ngushtë të aktit të ekspertimit, në të cilin nuk përcaktohet afati kohor për konsumin e dozave të gjetura të lëndës narkotike dhe nëse kjo sasi ka qenë vetëm për një përdorim. Në vlerësimin e situatës, subjekti duket se nuk ka marrë në konsideratë vendimin unifikues nr. 1/2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë mbajtur qëndrimin se: *Për shkak të njohurive të posaçme që kërkohen në fushën e toksikologjisë, gjykata për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lëndës narkotike të nevojshme për përdorim vetjak, duhet të thërrasë në çdo rast specialistë të fushës, si toksikologë apo mjekë terapistë, mendimi shkencor i të cilëve do të shërbejë si njëri prej kriterëve ku ajo do të mbështesë arsyetimin e vendimit të saj. Por, për zgjidhjen përfundimisht të çështjes, gjykata duhet të mbështetet edhe në kriterin tjetër, me të cilin lidhet ngushtësisht ai i pari, kriter ky që konkretizohet nëpërmjet sqarimit të rrethanave faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës narkotike apo psikotrope nga personi konkret (pikërisht në momentin e gjetjes së saj tek ose pranë tij), nëpërmjet zbatimit të kërkesave ligjore të Kodit të Procedurës Penale që vlejnë për realizimin me sukses të procesit të të provuarit, në përgjithësi.*

123. Trupi gjykues vëren se dhe në dokumentin “Konkluzione përfundimtare”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, subjekti i rivlerësimit është bazuar dhe ka dhënë të njëjtat fakte dhe argumente të paraqitura në vendimin për pushimin e hetimit ndaj personit nën hetim. Për rrjedhojë, rezulton se dhe në këtë dokument, subjekti i rivlerësimit është mbështetur vetëm në konkluzionet e aktit të ekspertimit toksikologjik, duke mos vlerësuar rrethanat e tjera faktike, sikurse janë posedimi i llojeve të ndryshme të lëndëve narkotike nga personi në hetim dhe dyshimeve se kryente aktivitet në shitjen e lëndës narkotike, duke konkluduar në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore dhe të jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se janë të bazuara konkluzionet e Komisionit se subjekti i rivlerësimit në trajtimin e këtij procedimi penal, ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesit e aftësisë për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
124. Lidhur me dosjen nr. {***}²³, që i përket procedimit penal nr. {***}, regjistruar në datën 16.12.2013, për veprën penale “Organizim i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Komisioni, në rezultatet e hetimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, me vendimin e datës 23.12.2014, ka vendosur pushimin e procedimit penal me arsyetimin se nga të dhënat e grumbulluara, nuk provohet që shtetasi F. D. të ketë organizuar dhe ushtruar aktivitet të lojërave të fatit dhe lotarive të palejuara, pasi nuk provohet që makinetat e lojërave të fatit të jenë përdorur prej tij. Komisioni, në rezultatet e hetimit, i ka kërkuar shpjegime subjektit për konstatimet se: *(i) Subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore pasi: nuk ka kërkuar informacion nga shoqëria “{***}” ShA nëse ka ushtruar aktivitetin në lokalit e shtetasit F. D., me qëllim qartësimin e faktit nëse organizmi i lojërave të fatit në ambientet e lokalit, është kryer nga ky shtetas apo nga shoqëria {***}; nuk ka kërkuar informacion nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit se cilët janë personat/subjektet*

²³ Një nga 5 dokumentet ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

që i mbajnë apo duhet t'i mbajnë çelësat e memories fiskale të aparateve elektronike, me qëllim kryerjen e veprimeve të mëtejshme për administrimin e tyre dhe përcaktimin e periudhës së përdorimit të aparateve elektronike; nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga NJMLF-ja lidhur me arsyet që ky institucion nuk është në gjendje të kontrollojë memorien fiskale të aparateve elektronike. Është i paqartë fakti që shtetasi F. D. nuk është marrë në përgjegjësi penale për vënien në dispozicion të lokalit për organizimin apo luajtjen e lojërave të fatit në kundërshtim me dispozitat ligjore, sipas parashikimit të nenit 198 të Kodit Penal.

125. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka prapësuar se ka arritur në konkluzionin se është e panevojshme pyetja e përfaqësuesve të shoqërisë “{***}” ShA, pasi përgjigja e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (në vijim “NJMLF”), Tiranë, për mospasjen e një marrëdhënieje kontraktuale midis firmës “{***}” ShA dhe shtetasit F. D., ishte shteruese në lidhje me individualizimin e përgjegjesisë penale. Çelësat fizikë dhe elektronikë mbahen nga poseduesit e makinetave të lojërave të fatit dhe nga veprimet e para hetimore të kryera nga policia e shtetit në vendngjarje, çelësat nuk janë gjetur dhe nuk janë sekuestruar nga ana e policisë gjyqësore, gjë e cila ka vështirësuar hetimin e çështjes dhe individualizimin e përgjegjesisë penale të autorit. Gjatë hetimit, nuk është provuar që mbajtja e pajisjeve ka qenë me qëllim ushtrimin e aktivitetit të paligjshëm në fushën e lojërave të fatit apo magazinimin e tyre me qëllim ruajtjeje. Subjekti ka parashtruar se nuk mund të konkludohej me marrjen në përgjegjësi penale të shtetasit F. D. apo dikujt tjetër, sipas parashikimeve të nenit 3 të Kodit Penal, pasi nuk ishte përcaktuar koha në të cilën, të paktën tri prej këtyre aparateve që kanë qenë në gjendje të rregullt teknike, janë shfrytëzuar për ushtrimin e këtij aktiviteti. Veprimi në kohë i ligjit penal, sa kohë që koha e kryerjes së veprës penale nuk mund të përcaktohet, ka të bëjë jo vetëm me parashikimin e nenit 3 të Kodit Penal si parim i përgjithshëm i së drejtës penale, por edhe me nenin 66 të Kodit Penal që bën fjalë për parashkrimin e ndjekjes penale.
126. Lidhur me paqartësinë e Komisionit pse shtetasi F. D. nuk është marrë në përgjegjësi penale për vënien në dispozicion të lokalit për organizimin apo luajtjen e lojërave të fatit, sipas parashikimit të nenit 198 të Kodit Penal, subjekti ka shpjeguar se nuk mund të merrej në përgjegjësi penale për këtë vepër, pasi referuar anës objektive të veprës penale të nenit 198 të Kodit Penal, kusht i domosdoshëm që vepra penale të jetë e konsumuar, duhet që në ambientet e një lokali të ushtrohet aktivitet i paligjshëm në fushën e lojërave të fatit. Sa kohë që nga hetimi nuk u provua vepra penale e parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, nuk provohet as vepra penale “Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara”, parashikuar nga neni 198 i Kodit Penal.
127. Komisioni ka vlerësuar si jobindës shpjegimin e subjektit se nga përvoja, çelësat fizikë dhe elektronikë mbahen nga poseduesit e makinetave të lojërave të fatit dhe kjo ka vështirësuar hetimin e çështjes dhe individualizimin e përgjegjesisë penale të autorit pasi, sipas logjikës së subjektit të rivlerësimit, mjafton që personat e dyshuar të veprës penale të mos dorëzojnë çelësat e memories fiskale të makinerive elektronike të lojërave të fatit, të vëna në punë në mënyrë të paligjshme, atëherë mbetet e paprovuar ana objektive e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal. Më tej, Komisioni arsyeton se edhe neni 198 i Kodit Penal, që parashikon veprën penale “Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara”, është një dispozitë e bardhë (blankete), pasi u referohet akteve ligjore dhe

nënligjore që rregullojnë organizimin e lojërave të fatit, lotarive dhe bixhozit. Nga ana objektive, kjo vepër penale kryhet me anë të veprimeve të drejtpërdrejta, duke vënë në dispozicion lokalit për organizimin e basteve, që nuk është pajisur me licencë për ushtrimin e kësaj veprimtarie, në kundërshtim me ligjin.

128. Sipas Komisionit, nuk qëndron dhe shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se shtetasi F. D. nuk mund të merrej në përgjegjësi penale për veprën penale të parashikuar nga neni 198 i Kodit Penal, pasi kushti i domosdoshëm që në ambientet e një lokali të ushtrohet aktivitet i paligjshëm në fushën e lojërave të fatit, nuk mbështetet në situatën faktike. Nga informacioni i marrë nga organi shtetëror përgjegjës, shoqëria “{***}” ShA nuk është pajisur me leje sekondare për hapjen e një pike në Përrenjas, në emër të shtetasit F. D., dhe ky shtetas nuk rezulton të jetë kontraktuar nga shoqëritë e lojërave të fatit. Gjithashtu, vërehet se shtetasi F. D. është marrë në pyetje nga oficeri i policisë gjyqësore, si person që ka dijeni për veprën penale, në datën 16.10.2013, dhe ka deklaruar se ka afro 10 muaj që lokalit ia ka dhënë shoqërisë “{***}” ShA, e cila ka futur lojëra fati. Pra, i dyshuari ka pranuar se ka vënë në dispozicion lokalit për organizimin e lojërave të fatit që nuk ishin pajisur me licencë nga organet përgjegjëse shtetërore.
129. Në përfundim, për këtë procedim penal, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
130. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të këtij procedimi penal, konstaton se : (i) Në datën 16.12.2013, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, bazuar në materialin kallëzues të paraqitur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan, në datën 18.10.2013, kanë ushtruar kontroll në ambientet e lokalit të shtetasit F. D. në qytetin e Përrenjasit, ku janë sekuestruar 10 makineta lojërash fati, pa dokumentacionin përkatës. (ii) NJMLF-ja, në përgjigje të kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan²⁴, me shkresën nr. {***}, datë 09.09.2014, ka konfirmuar se shoqëria “{***}” ShA nuk është e pajisur me leje ushtrimi veprimtarie për lojëra fati në asnjë lloj kategorie që parashikon ligji nr. 10033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit”, dhe se shtetasi F. D. nuk rezulton të jetë i kontraktuar nga shoqëritë e lojërave të fatit për ndonjë adresë sekondare në qytetin e Përrenjasit. (iii) Me vendimin e datës 23.06.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur kryerjen e ekspertimit teknik të 10 aparaturave elektronike të sekuestruara. Sipas aktit të ekspertimit teknik nr. {***}, datë 30.10.2014, ka rezultuar se aparatet elektronike kategorizohen për ushtrimin e aktivitetit në fushën e lojërave të fatit, nga të cilat 3 janë në gjendje të rregullt teknike dhe 7 të tjerat nuk rezultuan në gjendje të rregullt teknike. Ekspertët kanë konstatuar se këto aparate nuk janë të certifikuara nga NJMLF-ja dhe se nuk mund të përcaktojnë periudhën e përdorimit dhe shumën e luajtura, pasi nuk u janë vënë në dispozicion çelësat fizikë dhe elektronikë të memories fiskale. (iv) Shtetasi F. D. ka deklaruar se ka afro 10 muaj që i ka dhënë me qira lokalit shoqërisë “{***}” ShA, pa kontratë

²⁴ Me shkresën nr. {***}, datë 21.05.2014.

noteriale, dhe kjo shoqëri ka që në muajin maj që nuk i ka dhënë qiranë. Sipas tij, në lokal punonin shtetasit L. S. dhe A. B., të cilët disa herë i kishin dhënë dhe qiranë e lokalit. Për shkak se nuk i është paguar qiraja e lokalit, deklaruesi ka marrë çelësin e lokalit dhe ia ka dhënë vëllait të tij Y. D., duke pritur që ta likuidonte shoqëria. Deklaruesi nuk ka pasur dijeni sa aparate kanë qenë brenda lokalit. Nga procesverballi për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni, i datës 21.07.2014, rezulton se shtetasi L. S. ka deklaruar se nuk i njeh shtetasit F. D. dhe A. B., dhe se nuk ka asnjë lidhje me qytetin e Përrenjasit apo me lojërat e fatit që janë kapur në këtë qytet. (v) Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 23.12.2014, ka vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se nga të dhënat e grumbulluara, nuk provohet që shtetasi F. D. të ketë organizuar dhe ushtruar aktivitet të lojërave të fatit dhe lotarive të palejuara, pasi nuk provohet që makinetat e lojërave të fatit të jenë përdorur prej tij. Sipas vërtetimit të datës 24.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nuk rezulton që NJMLF-ja të ketë paraqitur ankim në këtë gjykatë.

131. Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, vlerëson se subjekti rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, nuk ka arritur të provojë të kundërtën, për sa është konstatuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për hetimin në mënyrë shteruese të çështjes. Pavarësisht shkresës së Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, nga e cila rezultonte se zyrtarisht nuk kishte asnjë lidhje midis shtetasit F. D. dhe shoqërisë “{***}” ShA, subjekti duhet të kishte thelluar hetimin duke kërkuar informacion dhe nga kjo shoqëri lidhur me çështjen. Gjithashtu, konstatohet se nuk është finalizuar marrja në pyetje e shtetasit A. B., në cilësinë e personit që kishte dijeni për veprën penale, si dhe nuk janë marrë në konsideratë, apo nuk është hetuar më tej për deklaratimet e shtetasit L. S., i cili ka mohuar çdo lidhje apo njohje me shtetasin F. D.. Subjekti i rivlerësimit nuk ka zhvilluar hetime të mëtijshme edhe lidhur me personat/subjektet që kishin apo duhet të kenë pasur në posedim çelësat fizikë dhe elektronikë të memories fiskale. Në mungesë të sqarimit të këtyre rrethanave, është i pabazuar vendimi i subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal, me argumentin se nuk provohet që shtetasi F. D. të ketë organizuar dhe ushtruar aktivitet të lojërave të fatit dhe lotarive të palejuara, pasi nuk provohet që makinetat e lojërave të fatit të jenë përdorur prej tij.
132. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se mbetet i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
133. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka informuar Komisionin se, për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi, ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë një kallëzim penal. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 15.12.2008, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Ekspertimit të rremë”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 309 të K. Penal, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Hektor Mushi dhe shtetasit A. K., ekspert mjekoligjor. Kallëzuesi F. B. ka pretenduar se në procedimin penal nr. {***}, datë 29.07.2007, regjistruar në Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Elbasan, të filluar për shkak të aksidentit automobilistik të datës 28.5.2007, ku ai ka mbetur i dëmtuar, mjeku ligjor A. K. ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, si dhe ka falsifikuar për qëllime fitimi, aktin mjekoligjor, duke u shprehur se dëmtimet e shkaktuara atij janë në kategorinë e dëmtimeve të lehta, ndërkohë që nga ekzaminimet e mëvonshme dhe trajtimi që ka bërë privatisht në një spital në Maqedoni, është vlerësuar si plagosje e rëndë, ku si pasojë pretendon se ka mbetur invalid nga njëra këmbë. Kallëzuesi ka akuzuar dhe prokurorin e çështjes Hektor Mushi pasi, sipas tij, në bashkëpunim me mjekun ligjor, kanë falsifikuar aktin mjekoligjor për qëllime përfitimi. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin e datës 30.4.2009, ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. {***}, datë 15.12.2008.

134. Komisioni, në vazhdim të hetimit lidhur me këtë çështje, mori në shqyrtim dosjen e procedimit penal nr. {***}, datë 29.7.2007, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit, si prokurori që ka ndjekur këtë procedim.
135. Nga aktet e këtij procedimi, rezulton se më datë 28.05.2007, në aksin rrugor Elbasan-Gostime, automjeti i tipit “Opel”, me targë {***}, i cili drejtohej nga shtetasi O. T., është përplasur me motoçikletën që drejtohej nga shtetasi F. B., i cili është dëmtuar dhe është dërguar në Spitalin Kirurgjikal të Elbasanit, ku ka rezultuar se ishte jashtë rrezikut për jetën. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 30.5.2007, shtetasit F. B. i janë shkaktuar dëmtime, që hyjnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë. Sipas aktit të ekspertimit auto-teknik të datës 7.6.2007, drejtuesi i automjetit nuk ka kryer shkelje të Kodit Rrugor, ndërsa drejtuesi i motoçikletës ka shkelur nenin 139, pika 2, dhe nenin 115, pika 1 e këtij kodi.
136. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 8.6.2007, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se, sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 30.5.2007, shtetasit F. B. i janë shkaktuar dëmtime që hyjnë në kategorinë që shkaktojnë paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë dhe, referuar parashikimeve të nenit 290/1 të Kodit Penal, meqenëse pasoja e ardhur nga ky aksident është e lehtë, fakti nuk parashikohet si vepër penale dhe procedimi penal nuk duhet të fillojë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në gjykatë të dëmtuari, ankim që është rrëzuar me vendimin nr. {***}, datë 27.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
137. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 10.04.2008, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues, me këtë arsyetim: *Prokurori Hektor Mushi [...] në marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal [...] i është referuar me keqinterpretim aktit mjekoligjor nr. {***}, dt. 30.05.2007, ku në pjesën arsyetuese të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, citon se ankuesit F. B. i janë shkaktuar dëmtime që hyjnë në ato që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë. Sipas aktit mjekoligjor të administruar në fashikullin e hetimit, eksperti mjekoligjor ka konkluduar se dëmtimet kanë shkaktuar paaftësi më tepër se 9 ditë. Ndonëse në marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, prokurori i çështjes nuk i referohet akt ekspertimit autoteknik, ky akt është në kontradiktë me informacionin për referimin e veprës penale dhe konkretisht: Në akt ekspertimit autoteknik, dt.7.6.2007, eksperti ka konkluduar*

se drejtuesi i automjetit nuk ka kryer shkelje të Kodit Rrugor, ndërsa drejtuesi i motoçikletës që është ankuesi, ka shkelur nenet 139/2 dhe 115/1 të Kodit Rrugor. Ndërsa në informacionin për referimin e veprës penale, dt.29.5.2007, ka cituar se: [...] automjeti tip “Opel”, me targë {***}, që drejtohej nga shtetasi O. T., ndërkohë që tentonte të hynte në gomisteri në parakalim të gabuar, ka humbur kontrollin e mjetit duke dalë në krahun e majtë të rrugës.

138. Pas kthimit të çështjes për rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 7.1.2009, ka vendosur prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal të datës 8.6.2008 të prokurorit Hektor Mushi dhe vazhdimin e hetimeve paraprake, duke caktuar dhe detyrat përkatëse²⁵. Gjykata ka arsyetuar se: [...] Në vendim prokurori ka vendosur që t’u njoftojë të interesuarve vendimin e tij për mosfillim të procedimit penal. Në fashikullin penal, nuk rezulton që ky vendim t’i jetë komunikuar të dëmtuarit F. B.. Për sa i përket vendimit të prokurorit për caktimin e ekspertit autoteknik, nga fashikulli penal rezultoi se ky vendim nuk është marrë konform nenit 179, pikat 1, 2, 3, 4 dhe nenit 180 të Kodit të Procedurës Penale. Përpos kësaj, eksperti i caktuar jo vetëm që nuk është ekspert auto-teknik, por në zbatim të nenit 183 të Kodit të Procedurës Penale, nuk i është marrë deklaratë në lidhje me përgjegjësinë morale dhe juridike për detyrën që do të kryejë. Për aktin mjekoligjor, edhe për këtë rast [...] për caktimin e ekspertit, nuk janë zbatuar dispozitat procedurale të mësipërme. Në kompozimin e aktit të ekspertimit, mjeku ligjor A. K. është mbështetur, kjo sipas thënieve të tij, në kartelën ditore të datës 28.05.2007 të Repartit të Urgjencës të Spitalit Kirurgjikal Elbasan, pa këqyrur të dëmtuarin [...]. Nën dritën e provave të reja të paraqitura nga vetë i dëmtuari dhe të marra nga institucionet e specializuara, rezulton që shkalla e dëmtimeve tek ankuesi është e ndryshme nga ato të konstatuara nga eksperti dhe konkluzioni i tij në aktin e ekspertimit.
139. Komisioni, në rezultatet e hetimit, i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: (i) Subjekti nuk ka kontrolluar rregullsinë e aktit të ekspertimit mjekoligjor në kushtet kur eksperti nuk ka bërë këqyrjen e të dëmtuarit, por është mbështetur vetëm në kartelën ditore të spitalit. (ii) Subjekti nuk ka verifikuar vendimin e datës 28.5.2007, të oficerit të policisë gjyqësore, për caktimin e shtetasit H. M. për kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik, në kushtet kur ky shtetas nuk është i regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale. (iii) Subjekti nuk e ka vlerësuar konkluzionin e aktit të ekspertimit autoteknik se “drejtuesi i automjetit nuk ka kryer shkelje të Kodit Rrugor”, në raport me dokumentin e referimit të veprës penale, ku pasqyrohet se “automjeti ka hyrë në drejtimin e lëvizjes së motoçikletës”.
140. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk ka kryer verifikimin e aktit të ekspertimit mjekoligjor, pasi nuk ka pasur dyshime lidhur me objektivitetin e konkluzionit të ekspertit. Sipas tij, nga praktika, kartelat ditore të spitalit dhe ato të shtrimit spitalor plotësohen dhe përpilohen nga mjekë specialistë të fushës përkatëse, mbi të cilat

²⁵1) Të caktohen ekspertë të rinj autoteknikë dhe mjekoligjorë, komform kërkesave procedurale të parashikuara nga nenet 179, 180, 183 të Kodit Penal. 2) Eksperti autoteknik apo grupi i ekspertëve të jenë specialistë të mirëfilltë të fushës përkatëse dhe jo policë të Komisarariatit. Këta ekspertë të mbështeten për kryerjen e ekspertimit në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, dt. 28.5.2007. 3) Eksperti mjekoligjor i caktuar komform kritereve procedurale, të kryejë aktin e ekspertit nën dritën e provave të reja, siç janë epikrizë përcjellëse e invalidit [...] etj.

konkludojnë edhe ekspertët mjekoligjorë. Lidhur me konstatimet e tjera, subjekti ka sqaruar se në vendimin për mosfillimin e procedimit penal, i është referuar vetëm ekspertimit mjekoligjor dhe jo aktit të ekspertimit autoteknik, pasi pasoja e ardhur sipas konkluzioneve të aktit të ekspertimit mjekoligjor, ishte ezauruese për vendimmarrjen.

141. Për sa parashtruar më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioni është fokusuar në vlerësimin që u ka bërë subjekti i rivlerësimit dy akteve të ekspertimit, vlerësim që ka çuar në marrjen prej tij të vendimit për mosfillimin e procedimit penal. Konstatohet se vepra penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, për të cilën është regjistruar procedimi penal, ishte e parashikuar në nenin 290 të Kodit Penal, sipas të cilit: *shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar si pasojë vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose plagosjen e lehtë të disa personave dënohet me gjobë ose me burgim deri në 10 vjet. Në vijim, neni 88²⁶ parashikonte se plagosje e rëndë ishte plagosja me dashje që ka sjellë si pasojë, ndërmjet të tjerave, dëmtimin e përhershëm të shëndetit ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të saj. Ndërsa në nenin 89²⁷, parashikohej se figura e veprës penale të plagosjes së lehtë konsumohet kur shkaktohet paaftësi e përkohshme në punë më tepër se 9 ditë. Sipas këtyre dispozitave ligjore, për sqarimin e anës objektive të veprës penale, ishte e nevojshme kryerja e akteve të ekspertimit mjekoligjor për të verifikuar pasojat ardhura nga shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor si dhe kryerja e aktit të ekspertimit autoteknik për të provuar fajësinë e personit të akuzuar.*
142. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor, shtetasit F. B. i janë shkaktuar dëmtime që hyjnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë. Subjekti i rivlerësimit, në vendimin për pushimin e çështjes, ka referuar në mënyrë jo të saktë se, sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor, shtetasit të mësipërm i është shkaktuar paaftësi e përkohshme në punë deri në 9 ditë. Komisioni, duke marrë në konsideratë se vetëm kjo pasaktësi nuk do të ndikonte në vendimin përfundimtar të pushimit të çështjes²⁸, ka konstatuar se eksperti mjekoligjor, për arritjen e konkluzionit, është mbështetur në kartelën ditore të datës 28.5.2007, të repartit të urgjencës të spitalit dhe jo në këqyrjen e të dëmtuarit²⁹, duke konkluduar se akti i ekspertimit mjekoligjor nuk është i plotë, pasi eksperti nuk ka bërë këqyrjen e të dëmtuarit, por është mbështetur vetëm në kartelën ditore të spitalit. Trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin, pasi subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me detyrat në kuadër të hetimit të çështjes, nuk ka verifikuar nëse akti i ekspertimit është hartuar i plotë dhe në përputhje me detyrat që eksperti ka pasur sipas vendimit për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të datës 28.05.2007, sipas të cilit atij i kërkohet kryerja e ekspertimit për të përcaktuar nëse ka dëmtime në shëndetin e të dëmtuarit.

²⁶ Neni 88: “Plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë, ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të saj, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”.

²⁷ Kodi Penal, neni 89: “Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

²⁸ Në rast se do të konstatohej se dëmtimi i ka shkaktuar paaftësi në punë deri në 9 ditë, ky fakt nuk parashikohet nga neni 290 i Kodit Penal. Edhe nëse do të konstatohet paaftësia në punë për më tepër se 9 ditë, në kushtet kur nuk janë plagosur disa persona, nuk konsiderohet si vepër penale.

²⁹ Në procesverbalin e datës 28.1.2009, të Prokurorisë Kavajë, eksperti mjekoligjor ka deklaruar se në kushtet kur pacienti nuk ndodhej në pavijon, ka marrë të dhënat nga kartela ditore e spitalit dhe ka hartuar aktin e ekspertimit.

143. *Lidhur me aktin e ekspertimit auto-teknik*, Komisioni ka konstatuar se: (i) Subjekti nuk ka verifikuar vendimin e datës 28.5.2007, të oficerit të policisë gjyqësore, për caktimin e shtetasit H. M. për kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik, në kushtet kur ky shtetas nuk është i regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse sipas parashikimeve të nenit 179, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale. (ii) Subjekti nuk e ka vlerësuar konkluzionin e aktit të ekspertimit autoteknik: “se drejtuesi i automjetit nuk ka kryer shkelje të Kodit Rrugor” në raport me dokumentin e referimit të veprës penale se automjeti ka hyrë në drejtimin e lëvizjes së motoçikletës.
144. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të çështjes, konstaton se eksperti H. M. që ka hartuar aktin e ekspertimit autoteknik, ka qenë me detyrë specialist për aksidentet pranë sektorit të Qarkullimit Rrugor në Komisariatit të Policisë Elbasan dhe, si i tillë, duke pasur njohuri të posaçme në degën përkatëse, plotëson kushtet e parashikuara në nenin 179, pika 1³⁰ e Kodit të Procedurës Penale. Por trupi gjykues vëren se në caktimin e ekspertit dhe në dhënien e detyrës nuk janë plotësuar parashikimet e nenit 183³¹ të po këtij kodi, pasi ekspertit nuk i është marrë deklaratë në lidhje me përgjegjësinë morale dhe juridike për detyrën që do të kryente. Gjithashtu, rezulton se në aktin e ekspertimit jepet konkluzioni se drejtuesi i automjetit nuk ka kryer shkelje të Kodit Rrugor, ndërkohë që ndryshe nga sa konkludon eksperti, oficeri i policisë gjyqësore, në aktin “Informacion për referimin e veprës penale”, të datës 29.05.2007, ka konstatuar se: *automjeti që drejtohej nga shtetasi O. T., me drejtim lëvizjeje për në Elbasan, ndërkohë që tentonte të hynte në gomisteri, në parakalim të gabuar, ka humbur kontrollin e mjetit duke dalë në krahun e majtë të rrugës dhe është përplasur me motorin me drejtim lëvizjeje për në Gostimë, që drejtohej nga shtetasi F. B.*
145. Në përfundim, për procedimin penal nr. {***}, datë 29.07.2007, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer një veprimtari të pamjaftueshme hetimore për të verifikuar rrethanat e ngjarjes, si dhe nuk ka verifikuar aktet e ekspertimeve të kryera në kuadër të procedimit penal, konkluzionet e tyre në raport me të dhënat e tjera të dala nga hetimi, si dhe respektimin e dispozitave procedurale penale përkatëse në hartimin e tyre. Kjo pamjaftueshmëri del dhe nga vendimmarrjet e gjykatave, të cilat kanë vendosur kthimin e çështjes për rigjykim dhe, më pas, prishjen e vendimit të subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal. Për rrjedhojë, mbetet i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit, në trajtimin e këtij procedimi penal, ka treguar mangësi profesionale, bazuar në aftësinë për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

³⁰ Kodi i Procedurës Penale, neni 179: “1. Caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse. Kur ekspertimi shpallet i pavlefshëm ose duhet të bëhet ekspertim i ri, organi procedues merr masa, kur është e mundshme, që detyra e re t’i besohet një eksperti tjetër.

³¹ Neni 183, “Caktimi i detyrës”: “1. Organi procedues, pasi sigurohet për identitetin e ekspertit, e pyet nëse ka shkaqe përjashtimi nga detyra e ekspertit, e paralajmëron për detyrimet e përgjegjësitë e parashikuara nga ligji penal, i formulon kërkesat e ekspertimit dhe e fton të bëjë këtë deklaratë: “I vetëdijshëm për përgjegjësinë morale dhe juridike për detyrën që marr përsipër, do ta kryej atë me ndershmëri e drejtësi dhe do të ruaj sekretin për të gjitha veprimet që lidhen me ekspertimin”.

146. Për subjektin e rivlerësimit, në Komision janë administruar 4 denoncime nga publiku, dhe Komisioni, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për tre prej tyre.
147. Bazuar në denoncimin e shtetasit A. E., i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për moskryerjen e hetimeve lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 20.12.2018, Komisioni, në rezultatet e hetimit, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *Administrimi i provave për identifikimin e kryerjes së veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, nuk shfaq ndonjë kompleksitet të veçantë, që të mund të justifikojë kohëzgjatjen e hetimeve paraprake për një periudhë prej 4 vitesh e 5 muajsh (deri në momentin e administrimit të shkresës së Prokurorisë Elbasan).*
148. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se hetimet janë zgjatur për shkak të transferimeve të herëpashershme të oficerëve të policisë gjyqësore që janë ngarkuar me këtë çështje, kallëzimeve të vazhdueshme nga ana e shtetasit A. E. në prokurori, problematikave të krijuara nga ekspertët në lidhje me ekspertimin teknik të ndërtimit, si dhe për shkak të konflikteve civile dhe penale që denoncuesi ka me të kallëzuarin për pronësinë e hidrocentralit. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se është administruar akti i ekspertimit teknik i ndërtimit dhe ka rezultuar se nuk jemi përpara veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Më tej, ai ka shpjeguar se akti i ekspertimit do t’i komunikohet kallëzuesit A. E., i cili, sipas të drejtave të tij procedurale, ka të drejtën e prapësimeve dhe kërkesave që çmon të bëjë.
149. Komisioni ka arsyetuar se vepra penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në paragrafin e parë dhe të dytë përfaqëson një vepër penale, e cila nuk kërkon domosdoshmërisht ardhjen e ndonjë pasoje konkrete, por mjafton prezenca materiale e një ndërtimi të realizuar në mungesë të lejes së dhënë nga organi përkatës administrativ, ndërsa sipas paragrafit të tretë kërkohet shkaktimi i pasojave të rënda ose kur ndërtimi pa leje kryhet për qëllim fitimi. Për pasojë, momenti kohor në të cilin subjekti i veprës penale do të përgjigjet penalisht për këtë figurë vepre penale, do të jetë kur vërtetohet objektivisht ndërtimi i realizuar, i cili plotëson nga ana objektive të gjitha elementet e parashikuara nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë e ndërtimit. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, duket se administrimi i provave për identifikimin e kryerjes së veprës penale, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, nuk shfaq ndonjë kompleksitet të veçantë, që të mund të justifikojë kohëzgjatjen e hetimeve paraprake për një periudhë prej 4 vitesh e 5 muajsh (deri në momentin e administrimit të shkresës së Prokurorisë së Rrethit Elbasan). Bazuar në arsyetimin e mësipërm, sipas Komisionit, krijohen dyshime të arsyeshme për zgjatjen e papërligjur të hetimeve për këtë procedim penal, duke prodhuar një perceptim negativ të publikut, matur nga syri i një vëzhguesi të zakonshëm, në drejtim të funksionimit të organit të akuzës.
150. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se evidentimi i mungesës së veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit për periudha të gjata e pa arsye të përligjura demonstroi mungesë të angazhimit e përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksioneve, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

151. Nga të dhënat që rezultojnë nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se hetimet paraprake lidhur me këtë procedim penal, kanë zgjatur tej afateve të arsyeshme. Sipas shkresës nr. {***}, datë 02.06.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, rezulton se prokurori Hektor Mushi ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 10.12.2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dhe se ky procedim penal vazhdon të jetë aktualisht në fazën e hetimit. Pasja e një procedimi penal nën hetim për një kohë kaq të gjatë, për më tepër që ai nuk paraqet tipologji të ndërlikuar për sa u përket hetimeve, konsiderohet nga trupi gjykues se dëshmon për mangësi të subjektit të rivlerësimit lidhur si me aspektin e njohurive ligjore, atyre organizative, ashtu edhe atyre që lidhen me etikën e magjistratit, të cilat kanë cenuar të drejtat e qytetarëve. Kjo sjellje e magjistratit ka shkaktuar zgjatjen e paarsyeshme të hetimeve për këtë procedim penal, e cila në vetvete, mbetet e papërligjur në asnjë rrethanë dhe prodhon gjithsesi një perceptim negativ të publikut, matur nga syri i një vëzhguesi të zakonshëm, në drejtim të funksionimit të organit të akuzës. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ngarkesë të lartë në punë, nuk mundën gjithsesi të justifikojnë në asnjë rast shtrirjen e hetimeve në harkun kohor të më shumë se 4 viteve, duke cenuar thelbin e veprimtarisë hetimore dhe parimin e sigurisë juridike për shtetasit e përfshirë në to.
152. Në konkluzion, lidhur me këtë denoncim, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar qëndrimi i mbajtur nga Komisioni se evidentimi i mungesës së veprimtarisë hetimore të subjektit për periudha të gjata e pa arsye të përligjura, demonstrojnë mungesë të angazhimit e përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksioneve, kriteret të parashikuara në pikën 2 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
153. Shtetasi M. P., avokat i të pandehurit K. D., ka denoncuar në Komision subjektin e rivlerësimit për mungesë profesionalizmi, pasi me mosveprimet e tij, ka shkaktuar pavlefshmërinë e akteve të hetimit. Komisioni ka administruar aktet e procedimit penal nr. {***}, paraqitur nga denoncuesi, si dhe vendimet gjyqësore lidhur me këtë procedim, përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 18.7.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nga të cilat rezulton se i pandehurit K. D., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, në formën e kryerjes më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, i ka marrë viktimës O. K., dy automjete tip “Range Rover”, njëri në pronësi të vjehrrit të tij, shtetasit G. Sh., dhe tjetri në pronësi të shtetasit O. K., me pretekstin për t’i blerë, por në fakt duke i mashtruar, duke mos u dhënë shumën për të cilën kishin rënë dakord.
154. Në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për konstatimet se: *Subjekti i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të pandehurit, si një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42, pika 2 e Kushtetutës, pasi nuk i ka njoftuar vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve dhe vendimin për caktimin e ekspertit për vlerësimin e dëmeve. Subjekti i ka mohuar të akuzuarit të drejtën të paraqesë deklarime në interes të tij pas marrjes së cilësisë si i pandehur, duke mos zbatuar parashikimet e neneve 34/a, pika 1, shkronja “gj” dhe 332/c, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.*

155. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se vendimi për zgjatjen e afateve të hetimeve për tre muaj, i është komunikuar personit nën hetim nga oficeri i policisë gjyqësore pranë IEVP Elbasan, i cili ka bërë shënimin që refuzon firmën dhe, në rastin e njoftimit të akuzës dhe njoftimit për përfundimin e hetimeve, i pandehuri ka refuzuar të nënshkruajë aktet, pavarësisht se është njohur me to dhe nuk ka bërë të ditur emrin e mbrojtësit me të cilin kërkonte të realizonte mbrojtjen. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto veprime ishin strategji e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, me qëllim ngritjen e pretendimeve jo të bazuara në prova dhe ligj dhe për zëvendësimin e tij si prokuror të çështjes, pasi ai kishte kundërshtuar në gjykatë kërkesën e të pandehurit për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në një masë më të butë. Për sa i përket mosnjoftimit të mbrojtësit apo të pandehurit në lidhje me caktimin e ekspertit vlerësues, subjekti ka shpjeguar se konkluzioni i aktit të ekspertimit nuk ka sjellë pasoja rënduese tek i pandehuri, pasi nuk i është njoftuar akuzë e re dhe njoftimi i akuzës është bërë jo mbi bazën e konkluzionit të aktit të ekspertimit vlerësues. Kryerja e riekspertimit të ri sipas detyrave të lëna nga gjykata, nuk ka sjellë ndryshim të akuzës ndaj të pandehurit nga ajo që ai ka ngritur. Në përfundim, për këtë procedim penal, subjekti ka sqaruar se me vendimin nr. {***}, datë 3.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili ka marrë formë të prerë në datën 21.3.2023, është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 3 vite burgim.
156. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, nga aktet e fashikullit të çështjes të administruara nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë i ngarkuar për hetimin e kësaj çështjeje, dhe në përfundim të hetimeve ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq përpara gjyqtarit të seancës paraprake. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me vendimin e datës 1.11.2021, ka vendosur kthimin e çështjes dhe deklarimin e pavlefshëm të akteve procedurale të përpiluara nga prokurori në fazën e hetimit, si: a) *vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 17.5.2021*; b) *vendimin për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit të datës 15.5.2021*; c) *aktin e ekspertimit autoteknik të ekspertit M. C. dhe urdhërimin për përsëritjen e akteve të mësipërme procedurale brenda dy muajve nga dita që vendimi merr formë të prerë*. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 23.11.2021, pa u ankimuar. Gjykata në vendimin e saj ka arsyetuar se: (i) *Sa i takon vendimit “Për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit”, ndërsa [...] në dispozitivin e vendimit, ndër të tjera, prokurori ka vendosur [...] “që ky vendim t’i komunikohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij [...]”, gjykata çmon se [...] kjo gjë nuk ka ndodhur, pasi jo vetëm që një komunikim i tillë nuk ka lënë gjurmë në aktet e dosjes [...], por kjo u pohua edhe nga vetë prokurori, i cili theksoi verbalisht se i pandehuri ka marrë dijeni për këtë veprim, por pa e treguar mënyrën e njoftimit dhe provën përkatëse [...] Të gjitha këto të drejta që të pandehurit ia njeh ligji aktualisht atij i janë mohuar, çka ka sjellë edhe paqartësitë, apo pretendimet në lidhje me vlerën e dëmit për vlerësimin e dy mjeteve të marra prej K. D. [...]. Gjykata çmon se sa kohë vendimi për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit u konsiderua një vendim i pavlefshëm për shkak të shkeljes së ligjit, atëherë [...] edhe aktet e mëpasme që varen nga ai janë të pavlefshme, çka do të thotë se akti i ekspertimit i kryer nga ana e ekspertit, mbi bazën e një vendimi të pavlefshëm, do të konsiderohet i tillë.* (ii) *Në lidhje me vendimin e prokurorit “Për zgjatjen e afateve të hetimit”, gjykata ka çmuar se: “[...] edhe ky vendim nuk del nga aktet e dosjes që t’i jetë komunikuar të pandehurit [...]”. Në bazë të nenit 324/3 [...] nenit 325 të Kodit të*

Procedurës Penale [...] rezulton fare i qartë detyrimi i prokurorit për t'ia njoftuar të pandehurit vendimin e tij të zgjatjes së afatit të hetimeve [...] për shkak se ndaj këtij vendimi i pandehuri ka të drejtën e tij të ankimit, të cilën në rastin konkret nuk e ka ushtruar, pikërisht për shkak të mosmarrjes dijeni për atë vendim [...]”. Sa kohë që ky veprim procedural është bërë nga prokurori në shkelje të ligjit, atëherë ai meriton të ribëhet. (iii) Në lidhje me pretendimin e të pandehurit se ai nuk është pyetur asnjëherë në prani të avokatit të tij apo pasi ka marrë cilësinë e të pandehurit, gjykata çmon se: “[...] edhe ky pretendim i të pandehurit duhet pranuar [...]. Nga aktet e dosjes rezulton se në momentin e ndalimit të të pandehurit [...] ai është pyetur në cilësinë e “personit që ka dijeni për veprën penale” dhe meqenëse në këtë dëshmi, ai ka demonstruar vetëpërgjegjësi penale, atëherë OPGJ-ja e ka ndërprerë pyetjen e tij për ta ripyetur në një fazë tjetër, në prani të mbrojtësit të tij. Nga data 8.3.2021, i pandehuri ka konfirmuar mbrojtjen me avokat të zgjedhur sipas prokurës së posaçme të depozituar përpara organit të hetimit, mirëpo edhe pas këtij fakti, i pandehuri nuk është ripyetur më, pasi sipas prokurorit, nuk është çmuar një gjë e tillë. Nisur nga kjo situatë, gjykata çmon se është e drejta e të pandehurit që në çdo shkallë edhe gjendje procedimi të pyetet apo të ripyetet në prani të avokatit të zgjedhur prej tij, të bëjë deklaratime të cilat ai i quan në interes të tij, gjë e cila i është mohuar”.

157. Lidhur me sa paraqitur më sipër, në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të qëndrimit të mbajtur nga Komisioni, trupi gjykues vëren se Kodi i Procedurës Penale, në nenin 324, pika 3, parashikon se prokurori u njofton të pandehurit dhe viktimës vendimin për zgjatjen e hetimeve, vendim i cili mund të ankimohet, sipas nenit 325, pika 1, brenda 10 ditëve nga njoftimi. Ndërsa lidhur me vendimin për caktimin e ekspertit, neni 179, pika 2 e këtij kodi parashikon se: *Vendimi i organit procedues për caktimin e ekspertit i njoftohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij, duke i bërë të ditur se ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit, të propozojë ekspertë të tjerë, të marrë pjesë vetë në ekspertim, kur është e mundur, dhe të parashtrojë pyetje për ekspertin.* Nga verifikimi i akteve, si dhe nga vetë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, rezulton se ai nuk i ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në dispozitat e mësipërme për njoftimin e të pandehurit ose të avokatit për vendimin për zgjatjen e hetimeve dhe vendimin për caktimin e ekspertit, duke i mohuar të drejtën e ankimit në gjykatë të këtyre vendimeve. Konstatohet se ndërsa për mosnjoftimin e vendimit për caktimin e ekspertit, subjekti e pranon që ky akt nuk i është njoftuar të pandehurit, pasi *konkluzioni i aktit të ekspertimit nuk ka sjellë pasoja rënduese tek i pandehuri*, për vendimin për zgjatjen e hetimeve, subjekti ka pretenduar në Komision se ky vendim i është komunikuar personit nën hetim nga oficeri i policisë gjyqësore. Ky fakt, përveçse nuk vërtetohet nga aktet, është dhe në kundërshtim me sa ka deklaruar vetë subjekti në seancat gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës së tij për dërgimin në gjyq të çështjes/procedimit penal nr. {***}. Sipas vendimit të datës 01.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, subjekti i rivlerësimit në seancë është shprehur se: *vendimi për zgjatjen e afateve të hetimit në momentin që është përpiluar akti nuk i është komunikuar mbrojtësit dhe të pandehurit, por mbrojtësi ka marrë dijeni menjëherë pas zgjatjes së hetimeve. Vendimi i zgjatjes së hetimeve nuk i është komunikuar të pandehurit në datën që është përpiluar, por i është komunikuar në përfundim të hetimeve.*

158. Për sa u përket pretendimeve të denoncuesit, avokatit të të pandehurit, se ky i fundit nuk është pyetur në prani të mbrojtësit, sillet në vëmendje se neni 37 i Kodit të Procedurës Penale parashikon:

*Një person, që nuk është marrë si i pandehur përpara organit procedues, bën deklaratime, nga të cilat dalin të dhëna për inkrimimin në ngarkim të tij, atëherë organi procedues ndërpret pyetjen, duke e paralajmëruar se pas këtyre deklaratimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe e fton të caktojë një mbrojtës. Sipas procesverbalit të datës 16.02.2021, rezulton se personi nën hetim, K. D., në momentin e ndalimit ka deklaruar se meqenëse implikohet, në bazë të nenit 37 të Kodit të Procedurës Penale, ndërpret deklarinimin për t'u pyetur në një fazë tjetër, në prani të mbrojtësit. Po nga aktet, rezulton se pas njoftimit të akuzës, i pandehuri K. D. ka konfirmuar mbrojtjen me avokat, sipas prokurës së posaçme të depozituar përpara organit të hetimit më datë 8.3.2021, por nuk është ripyetur më. Gjithashtu, rezulton se i pandehuri nuk ka pranuar firmosjen e akteve pa njoftimin/prezencën e mbrojtësit, i cili është njoftuar për aktet lidhur me procedimin penal vetëm me shkresën nr. {***} prot., datë 12.08.2021, të drejtuesit të prokurorisë, pas përfundimit të hetimeve dhe dërgimit të çështjes në gjykatë. Sipas vendimit të gjykatës, në seancën gjyqësore, subjekti i rivlerësimit është shprehur se nuk është bërë pyetja e të pandehurit në prani të avokatit, sepse kështu është çmuar nga ana e tij, pasi në bazë të provave të mbledhura, çështja ishte shumë e qartë. Këto veprime të subjektit të rivlerësimit si prokuror i çështjes, kanë sjellë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, siç rezulton nga vendimi gjyqësor i datës 01.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, deklarinimin të pavlefshëm të akteve procedurale nga ana e prokurorit në fazën e hetimit dhe urdhërimin nga gjykata për përsëritjen e tyre.*

159. Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në hetimin e procedimit penal nr. {***}, ka kryer shkelje procedurale duke mos respektuar dispozitat ligjore për njoftimin e akteve, si dhe për pyetjen e të pandehurit në praninë e mbrojtësit të caktuar prej tij me prokurë, që kanë sjellë si pasojë vendimin e gjykatës për pavlefshmërinë e akteve procedurale të përpiluara në fazën e hetimit paraprak. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se mbetet i bazuar qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit jo vetëm që ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, por ka demonstruar gjatë ndjekjes së çështjes e, më pas, në gjykim, mungesë të përgjegjshmërisë në ushtrimin e detyrës, dhe se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi: (i) në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të marrë urdhra dhe vendime, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) në aspektin e etikës në punë të magjistratit lidhur me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
160. Për sa i përket denoncimit të shtetasit A. H., lidhur me procedimin penal nr. {***}, Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme nëse në arkivën e institucionit rezulton e regjistruar një ngjarje ndërmjet një shtetaseje bullgare dhe subjektit të rivlerësimit, kohës që ushtronte detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë Pogradec, si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të mbajtur lidhur me të.
161. Nga aktet e dërguara në Komision nga Prokuroria e Shkallës së Parë Elbasan, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.09.2023, rezulton se në datën 27.9.2001 shtetasja bullgare P. Z. ka bërë kallëzim në Drejtorinë e Policisë Elbasan për veprime të paligjshme të kryera nga ana e prokurorëve Hektor Mushi dhe I. Gj.. Mbi bazën e materialit kallëzues në ngarkim të prokurorëve

Hektor Mushi dhe I. Gj., me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, është regjistruar procedimi penal nr. {***} dhe hetimet janë ndjekur nga Prokuroria e Përgjithshme.

162. Sipas vendimit për pushimin e procedimit penal, të datës 07.01.2002, të prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se më datë 26.9.2001, prokurorët e rretheve Librazhd e Pogradec, përkatësisht I. Gj. dhe Hektor Mushi po ktheheshin nga shërbimi me automjetin tip Benz që drejtohej nga shoferi i Prokurorisë së Rrethit Librazhd, duke udhëtuar në itinerarin Pogradec-Elbasan. Rreth orës 22:00, në zbritje të kthesave të Qafë-Thanës, automjeti i tyre është parakaluar me një shpejtësi të madhe nga një automjet me targë të huaj. Të dy prokurorët kanë konstatuar se në automjet ndodhej vetëm drejtuesi i tij dhe, duke parë shpejtësinë e madhe të lëvizjes së mjetit, faktin se ishte me targë të huaj dhe po lëvizte në orët e vona të natës, u ka lindur dyshimi se automjeti mund të ishte i vjedhur ose në të mund të kishte lëndë narkotike. Në këto rrethana, ata kanë urdhëruar shoferin e tyre të rriste shpejtësinë e lëvizjes me qëllim që ta ndalonin atë. Pasi kanë ecur për disa kilometra, i kanë bërë shenjë makinës dhe e kanë ndaluar. Menjëherë të dy prokurorët kanë dalë nga makina e tyre dhe kanë vajtur te makina që ishte me targë të huaj. Aty kanë konstatuar se mjeti drejtohej nga shtetasja bullgare P. Z. dhe në makinën e saj, nuk kishte asnjë person tjetër. Fillimisht të dy prokurorët i kanë kërkuar shpjegime se përse lëvizte me shpejtësi në orët e vona të natës dhe se nga vinte dhe kush ishte, si dhe dokumentacionin e saj për qëndrim në Shqipëri dhe atë të mjetit. Shtetasja bullgare, pasi ka sqaruar se ishte me kombësi e shtetësi bullgare, nuk ka pranuar që t'u jepte dokumentacionin, por me insistimin e prokurorëve, ajo është shoqëruar në ambientet e jashtme të Komisarariatit të Policisë Librazhd, ku, pasi prokurorët kanë bërë verifikimin e dokumenteve të shtetases bullgare dhe të mjetit të saj, në orën 2:30 të datës 27.9.2001, e kanë lejuar të vazhdojë rrugën në drejtim të Tiranës. Shtetasja P. Z., pasi ka dalë nga ambientet e Komisarariatit të Policisë Librazhd, është drejtuar në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Elbasan dhe ka bërë kallëzim për dy prokurorët, duke pretenduar se ata e kishin fyer në rrugë kur e kishin ndaluar dhe e kishin goditur e fyer edhe në ambientet e Komisarariatit të Policisë së Librazhdit. Pasi është marrë ky kallëzim nga oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan, asaj i është kërkuar që të bënte dhe ekzaminimin mjekoligjor, sipas vendimit të datës 27.9.2001, të nxjerrë nga oficeri i policisë gjyqësore. [...] Për të verifikuar e provuar pretendimet e kësaj shtetaseje për të dy prokurorët, është bërë këqyrja e librave të shërbimit dhe të shoqërimit të personave në Komisariatin e Policisë Librazhd, nga ku rezulton se kjo shtetase nuk është shoqëruar, ndaluar apo arrestuar në flagrancë. Janë pyetur në cilësinë e dëshmitarëve punonjësit e policisë të Komisarariatit Librazhd, të cilët kanë deklaruar se ndaj kallëzueses nuk është ushtruar dhunë nga dy prokurorët.
163. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 28.09.2001, ka rezultuar se në trupin e kallëzueses janë konstatuar ekimoza dhe ënjtje, të cilat janë shkaktuar me mjete të forta mprehëse dhe kanë shkaktuar humbjen e aftësisë së përkohshme deri në 9 ditë. Nga përmbajtja e procesverbalit të kallëzimit penal të datës 27.9.2001 dhe procesverbalit të datës 11.10.2001 mbi marrjen në pyetje të së dëmtuarës P. Z., personi që kallëzuesja ka pretenduar që e ka fyer dhe goditur përkon me subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi.
164. Në përfundim të hetimeve, prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme, me vendimin e datës 7.1.2002, ka vendosur pushimin e hetimeve me arsyetimin se pavarësisht nga kallëzimi dhe ekspertimi

mjekoligjor, nuk provohet që shtetasit Hektor Mushi e I. Gj. të kenë kryer veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare apo ndonjë vepër tjetër penale.

165. Komisioni, në rezultatet e hetimit, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime për konstatimin se: *Mbetet i paqartë fakti se në cilat dispozita ligjore i ka mbështetur veprimet e tij për ndalimin e makinës së shtetases bullgare e, më pas, shoqërimit të saj në Komisariatit të Policisë Librazhd.*
166. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Fakti ka ndodhur në territorin juridiksional të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Librazhd. Shoqërimi i kësaj shtetaseje bashkë me automjetin e saj, është kryer nga Prokurori i Rrethit Librazhd I. Gj.. Në rastin konkret, unë kam mbajtur rol pasiv gjatë shoqërimit të saj në polici, por edhe gjatë verifikimeve që janë kryer nga ana e Komisariatit të Policisë Librazhd, pasi nuk ka pasur të drejta juridiksionale për t'u marrë me rastin në fjalë. Shkaku i shoqërimit të kësaj shtetaseje jashtë Komisariatit të Policisë Librazhd është shpjeguar në aktet e procedimit penal të hetuar nga Prokuroria e Përgjithshme. Nuk e mohoj faktin që kam qenë i pranishëm, por siç shpjegova më lart, kam mbajtur pozicion neutral dhe inaktiv. Kallëzimin kjo shtetase e ka bërë në Drejtorinë e Policisë Elbasan, kur në atë kohë marrëdhëniet midis drejtuesit të Policisë Elbasan dhe prokurorisë në përgjithësi kanë qenë tej mase të acaruar, fakt i ditur publikisht. Besoj që ky ka qenë shkaku edhe i përfshirjes sime në kallëzimin e shtetases bullgare. Ndërsa lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimeve se në cilat dispozita ligjore i ka mbështetur veprimet e tij për ndalimin e makinës së shtetases bullgare e, më pas, shoqërimit të saj në Komisariatit të Policisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime në Komision.*
167. Komisioni ka konstatuar se pretendimi i subjektit se ka mbajtur qëndrim pasiv në këtë ngjarje, nuk mbështetet në aktet e dosjes penale pasi: (i) kallëzuesja në kallëzimin e saj ka pretenduar se subjekti e ka fyer dhe goditur; (ii) në procesverbalin e datës 27.9.2001, oficeri i shërbimit në Komisariatit të Policisë Librazhd, M. B., ka deklaruar se ka parë prokurorin I. Gj. dhe dy persona të tjerë që ishin të nxehur dhe po e pyesnin shtetasen bullgare duke bërë titull në oborrin e komisarariatit dhe jo në zyrë; (iii) në procesverbalin e datës 25.10.2001, gjatë marrjes në pyetje nga oficeri i policisë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se së bashku me prokurorin I. Gj., pasi e kanë ndaluar, kanë zbritur nga makina për të komunikuar me drejtuesen e mjetit dhe i kanë kërkuar të zbriste nga makina, si dhe i kanë bërë disa pyetje. Gjithashtu, ka shpjeguar se bashkë me prokurorin tjetër kanë biseduar me këtë shtetase në oborrin e komisarariatit dhe në këto biseda, nuk ka marrë pjesë ndonjë person tjetër dhe, meqenëse ishte e revoltuar, janë munduar të komunikojnë korrekt me të. Më tej, ka sqaruar se bashkë me prokurorin I. Gj., kanë verifikuar dokumentacionin identifikues të shtetases bullgare dhe të makinës. Gjithashtu, konstatohet se në të gjithë përmbajtjen e procesverbalit, subjekti i rivlerësimit për të gjitha veprimet e kryera, është shprehur në vetën e tretë shumës, duke sqaruar se veprimet me këtë shtetase janë bërë nga ai dhe prokurori I. Gj..
168. Nga verifikimi i akteve të procedimit penal, trupi gjykues vëren se qëndrojnë konstatimet e mësipërme të Komisionit, lidhur me qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit në çështjen në fjalë. Nga këto akte, rezulton se subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga sa ka pretenduar gjatë hetimit

në Komision, ka qenë aktiv gjatë gjithë ngjarjes, duke marrë në pyetje dhe komunikuar me shtetasen bullgare P. Z., si në prani të prokurorit tjetër, ashtu dhe vetëm me të. Ky fakt konfirmohet nga vetë subjekti, sipas procesverbalit të datës 25.10.2001, të mbajtur nga prokurori që ndiqte çështjen penale në ngarkim të tij dhe në të cilin vetë subjekti ka sqaruar veprimet që kanë kryer së bashku me prokurorin tjetër gjatë ngjarjes, dhe ku për asnjë moment nuk është shprehur se ka qëndruar pasiv. Qëndrimi dhe përfshirja e subjektit në ngjarje konfirmohet dhe nga deklaratimet e dhëna nga punonjësit e policisë, të cilët pavarësisht se janë shprehur se nuk kanë parë akte dhune, kanë dhënë sqarime dhe kanë dëshmuar për veprimet e kryera nga të dy prokurorët, njëri prej të cilëve ishte subjekti i rivlerësimit.

169. Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka sqaruar gjatë hetimit në Komision se mbi cilat dispozita procedurale ligjore, ai dhe kolegu i tij kanë kryer veprimet për ndalimin dhe shoqërimin e shtetasës në ambientet e komisariatit të policisë, si dhe për marrjen në pyetje të saj në këto ambiente, ndërkohë që statusi i tyre si prokurorë nuk ua mundësonte veprime të tilla.
170. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mbetet i bazuar qëndrimi i Komisioni, i cili duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 84/2016, që në nenin 40³² parashikohet se vlerësimi i veprimtarisë etike përfshihet brenda objektit të vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe parashikimin e pikës 4 të nenit 41³³, që përcakton se periudha e vlerësimit të aftësive profesionale mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim, ka çmuar se konstatimet e mësipërme vlerësohen në kuadër të sjelljes së vazhdueshme profesionale, etike që ka shfaqur subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit.
171. Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan aktet që i përkasin procedimit penal nr. {***} të vitit 2016, pasi ka marrë dijeni, nëpërmjet mediave elektronike³⁴, për ankesën e shtetasit B. B. ndaj subjektit të rivlerësimit Hektor Mushi³⁵.
172. Sipas akteve të këtij procedimi penal, rezulton se në datën 12.11.2016, në fshatin Tregan, Elbasan, është vjedhur banesa e shtetasit B. B., i cili ka pretenduar si i janë vjedhur rreth 900.000 lekë. Nga hetimet e zhvilluara, nuk është bërë i mundur identifikimi i autorëve e, për pasojë, prokurorja e çështjes E. S., me vendimin e datës 11.04.2017, ka vendosur pezullimin e hetimeve. Më pas, i dëmtuari ka gjetur një letër anonime në banesën e tij, në të cilën autori i paidentifikuar ka deklaruar se ka parë komshiun e B. me triko e kapuç, çizme dhe çekiç në dorë nga dritat e një makine. Gjithashtu, i dëmtuari në datën 23.01.2018, ka deklaruar para policisë gjyqësore se nga biseda që ka pasur me punonjësin e policisë së zonës dhe duke mbledhur informacion nga shokë e miq, ka

³² Sipas nenit 40: “Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve [...]”.

³³ Sipas nenit 41: “4. Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale [...]”.

³⁴ <https://top-channel.tv/2019/05/20/fiks-fare-skandali-i-prokurorise-3-vjet-asnje-hetim-per-grabitjen-e-13-milione-lekeve/>

³⁵ Dërguar me shkresë nr. {***} prot., datë 26.06.2023.

arritur në konkluzionin se autorë të vjedhjes janë disa shtetas, të cilët ai i ka identifikuar duke dhënë edhe emrat përkatës.

173. Me vendimin e datës 16.2.2018, prokurorja E. S. ka vendosur rifillimin e hetimeve. Me kërkesë të të dëmtuarit, drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurores së çështjes me prokurorin Hektor Mushi. Pas rifillimit të hetimeve, janë marrë në pyetje disa shtetas, si dhe është marrë informacion nga kompanitë telefonike lidhur me numrat e disa personave të dyshuar. Me kërkesë të oficerit të policisë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka proceduar me lejimin e përgjimit të bisedave dhe ka kërkuar nga gjykata vleftësimin e vendimit të përgjimit telefonik. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin e datës 16.5.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit. Nga dëgjimi dhe transkriptimi i bisedave, nuk ka rezultuar ndonjë bisedë me interes për hetimin.
174. Në datën 20.5.2019, emisioni investigativ “Fiks Fare”, në televizionin “Top Channel”, ka transmetuar një regjistrim bisede të bërë nga shtetasi B. B. me oficerin e policisë gjyqësore S. Sh. dhe prokurorin Hektor Mushi. Gjatë regjistrimit të bisedës, rezulton se prokurori Hektor Mushi ka marrë kontakt me të dëmtuarin, shtetasin B. B., jashtë ambienteve të Prokurorisë dhe, gjatë bisedës me të, në përgjigje të pohimit të qytetarit se: *Dua me i dalë në fund se s’bën kësaj pune*, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: *Po gjeje more burrë, po deshe bëje dhe me vetëgjyqësi*. Më pas ka vijuar biseda dhe subjekti i rivlerësimit ka sqaruar qytetarin se: *Janë marrë ato numrat [...] do vihen në përgjim. Javën që vjen do bëhet kërkesa në gjykatë*, si dhe është shprehur se: *[...] ndihem fajtor në njëfarë mënyre, sepse duhej të isha marrë më shumë me këtë punë*. Pas transmetimit të regjistrimit të mësipërm, drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me vendimin e datës 22.5.2019, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit Hektor Mushi nga ushtrimi i mëtejshëm i ndjekjes penale, në kuadër të procedimit penal nr. {***} të vitit 2016, duke pasqyruar edhe mangësitë e konstatuara në kryerjen e hetimeve paraprake nga subjekti i rivlerësimit.
175. Nisur nga rrethanat e mësipërme të rezultuara nga aktet, në përfundim të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit sqarime lidhur me konstatimet se: (i) Veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti në procedimin penal nr. {***}, janë të shkëputura në kohë, duke sjellë si pasojë zgjatjen e paarsyeshme të hetimeve paraprake. (ii) Subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për mbledhjen e provave të nevojshme për zbulimin e autorit/autorëve të veprës penale pasi: a) nuk rezulton që subjekti të ketë urdhëruar marrjen në pyetje të oficerit të policisë që ka komunikuar me të dëmtuarin; b) nuk rezulton që subjekti të ketë urdhëruar verifikimin e alibive të personave të marrë në pyetje të cilët janë përmendur nga i dëmtuari si autorë të veprës penale. (iii) Subjekti nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore pasi: (a) veprimet hetimore janë të shkëputura në kohë; (b) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për zbulimin e autorit/autorëve të veprës penale. (iv) Takimi i subjektit me të dëmtuarin nga vepra penale në ambientet publike, duke diskutuar për çështjen konkrete, duke i thënë se nëse dëshironte mund të bënte vetëgjyqësi, si dhe vënia në dijeni e të dëmtuarit për veprimet procedurale hetimore, nuk janë në përputhje me rregullat e etikës dhe sjelljen e prokurorit.

176. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në Komision se në momentin kur është ngarkuar me drejtimin e hetimeve, kishin kaluar gati 16 muaj nga ndodhja e ngjarjes, gjë që sipas tij e ka bërë shumë të vështirë gjetjen e provave të reja, me qëllim identifikimin e autorëve të veprës penale. Sipas tij, çështja penale konsistonte në të dhëna sipërfaqësore dhe indicie jo të verifikuara dhe, për pasojë, arriti në konkluzionin që e vetmja mënyrë e mundshme për të bërë të mundur identifikimin e autorëve, ishte kryesisht nëpërmjet përgjimeve telefonike. Për këtë arsye, vijon subjekti i rivlerësimit, i është kërkuar oficerit të policisë gjyqësore identifikimi i numrave personalë telefonikë celularë të personave të pretenduar nga kallëzuesi, por pas identifikimit përcjellja e tyre nuk ka qenë në formën e kërkuar nga ligji. Sipas tij, të gjitha këto shkaqe kanë sjellë vonesa në lidhje me përfundimin e hetimeve dhe pakënaqësi te personat e dëmtuar nga vepra penale.
177. Subjekti ka shpjeguar se për shkak të pakënaqësisë së shprehur në mënyrë të vazhdueshme nga i dëmtuari, ka marrë disa herë kontakte dhe takime me të, duke u përpjekur ta sqarojë dhe njëkohësisht ta qetësojë lidhur me ecurinë e hetimit. Për sa i përket shprehjes për përdorimin e vetëgjyqësisë, të shfaqur në emisionin “Fiks Fare”, subjekti ka sqaruar se këtë shprehje e ka përdorur në mënyrë ironike, pasi shtetasi B. B. gjatë gjithë takimeve që ka bërë me të, e ka përdorur vazhdimisht se do të kryente vetëgjyqësi nëse prokuroria nuk do të arrestonte personat që ai pretendonte se ishin autorë të ngjarjes.
178. Për sa i përket faktit se ka nxjerrë sekretin hetimor, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ky konstatim nuk qëndron, pasi nuk e ka vënë në dijeni për emra personash dhe për numrat telefonikë që do të vihen në përgjim dhe komunikimin në lidhje me çështjen e personit të dëmtuar, nuk e konsideron shkelje etike, për shkak se ai ishte personi i dëmtuar dhe i interesuar për zbardhjen e çështjes. Subjekti ka sqaruar se transmetimi në emisionin “Fiks Fare” u bë shkak që të mos realizohen me sukses përgjimet që kishin nisur e ishin në vazhdim, me afat 15-ditor të caktuar nga gjykata dhe se procedimi penal në fjalë ndodhet i pezulluar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan për moszbulim të autorit të veprës penale, vendim i marrë nga një tjetër prokuror pas zëvendësimit të tij.
179. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, në trajtimin e këtij procedimi penal, ka shfaqur mangësi në aspektin: (i) e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të përcaktuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) aftësia organizative, kriter që parashikohet nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016; (iii) etika e magjistratit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, kritere të parashikuara nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.
180. Referuar rrethanave të evidentuara nga aktet e procedimit penal, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në momentin kur ka marrë në ngarkim çështjen, nuk ka kryer asnjë veprim për të verifikuar disa nga informacionet që ka deklaruar se kishte mbledhur personi i dëmtuar, shtetasi B. B.. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë marrë në pyetje punonjësën e policisë së zonës, i cili ka pasur dijeni për ngjarjen, apo të ketë urdhëruar verifikimin e alibive të personave të dyshuar nga personi i dëmtuar. Në këto kushte, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin se

subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për mbledhjen e provave të nevojshme për zbulimin e autorit/autorëve të veprës penale, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të përcaktuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

181. Gjithashtu, nga aktet e procedimit penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit është caktuar në ndjekjen e çështjes në datën 23.2.2018, dhe në datën 20.3.2018 ka nxjerrë urdhrin për delegimin e veprimeve hetimore oficerit të policisë gjyqësore, duke i përcaktuar edhe veprimet hetimore që duheshin kryer. Në datën 26.4.2018, është marrë në pyetje shtetasi B. P. dhe në datën 28.12.2018, është marrë në pyetje shtetasi A. Gj., si persona që kanë pasur dijeni për veprën penale. Oficeri i policisë gjyqësore ka kërkuar informacion nga kompanitë e telefonisë lidhur me përdoruesit e numrave telefonikë në datën 21.9.2018 dhe përgjigjet e tyre janë protokolluar në datat 5.10.2018 dhe 22.11.2018. Në vijim, oficeri i policisë gjyqësore, në datën 17.12.2018, i ka paraqitur kërkesë subjektit të rivlerësimit, si prokuror i çështjes, për lejimin e përgjimit telefonik, si dhe e ka përsëritur kërkesën në datën 5.2.2019. Subjekti, me vendimin e datës 14.5.2019, ka vendosur lejimin e përgjimit telefonik dhe në datën 15.5.2019, ka paraqitur në gjykatë kërkesën për vleftësim të ligjshëm të vendimit. Nga të gjitha veprimet e renditura më sipër, konstatohet se veprimet hetimore për zbulimin e autorit/autorëve të veprës penale janë të shkëputura në kohë, me zvarritje në intervale disamujore, duke sjellë si pasojë vonesë në kryerjen e veprimeve procedurale dhe, për rrjedhojë, në hetimin e çështjes. Këto mangësi janë konstatuar dhe nga drejtuesja e prokurorisë, e cila në vendimin e datës 22.05.2019 për zëvendësimin e prokurorit/subjektit të rivlerësimit pas transmetimit të emisionit televiziv, ka konstatuar se veprimet hetimore janë kryer të shkëputura në kohë, duke i sjellë hetimit moskonsistencë, si dhe nuk ka pasur një linjë të qartë të planit hetimor. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, duke shfaqur mangësi në aspektin e aftësive organizative, kriter që parashikohet nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016.
182. Sa i përket regjistrimit të komunikimit të subjektit me të dëmtuarin, të transmetuar nga emisioni televiziv, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve në fuqi në kohën e regjistrimit të emisionit³⁶, nuk ka ruajtur sekretin e hetimeve, duke dhënë informacion lidhur me veprimet procedurale hetimore në vijim, si dhe ka dhënë opinione personale lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjes, duke i sugjeruar të dëmtuarit zgjidhjen joligjore, me vetëgjyqësi.
183. Në përfundim të sa më sipër, lidhur me procedimin penal nr. {***}, trupi gjykues vlerëson se janë të bazuara konkluzionet e Komisionit për mangësi të subjektit të rivlerësimit në aspektin: (i) e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të përcaktuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) e aftësive organizative, kriter që parashikohet nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016; (iii) e etikës së magjistratit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, kritere të parashikuara nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

³⁶ Të miratuara me urdhrin nr. {***}, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm.

184. Në konkluzion, për kriterin e vlerësimit profesional, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë informacionet e përcjella nga organet ndihmëse në çështjet penale të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit, mangësitë e konstatuara në mënyrë të vazhdueshme për sa u përket njohurive ligjore në praktikat e regjistruara, si dhe shkeljet e përsëritura në aspektin e etikës, në vlerësimin tërësor të fakteve dhe rrethanave, çmon se problematikat e konstatuara në kriterin e kontrollit të figurës, të ndërthurura me mangësitë e aftësive profesionale, janë të tilla që kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë e, për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
185. Në përmbledhje të sa është konstatuar më sipër, në një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, për shkak të kontaktit të papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit D dhe pikës 3 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikave 3, 2 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 725, datë 15.12.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 725, datë 15.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Hektor Mushi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 31.10.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi